



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 23 DHJETOR 2022**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 23. DECEMBRA 2022. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR
2022**

Rendi i ditës

1. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,
2. Deklarimet jashtë rendit të ditës,
3. Pyetjet parlamentare,
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-198 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë për Programin e Financave Publike dhe Rritjes Ekonomike ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-052 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-152 për antidopingun,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-072 për bujqësi dhe zhvillim rural,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-145 për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-190 për zhvillimin rajonal të balancuar,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-185 për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore,
11. Debat parlamentar në lidhje me raportin e Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2022,
12. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës për vitin 2021.

Dnevni red

1. Usvajanje zapisnika sa prethodnih sednica,
2. Izjave van dnevnog reda,
3. Poslanička pitanja,
4. Razmatranje N/zakona br. 08/L-198 o ratifikaciji Sporazuma o kreditu za Program javnih finansija i ekonomskog rasta između Republike Kosovo i OPEC fonda za međunarodni razvoj,
5. Drugo razmatranje N/zakona br. 08/L-052 o izmenama i dopunama Zakona br. 05/L-010 o Kosovskoj agenciji za upoređivanje i verifikaciju imovine,
6. Drugo razmatranje N/zakona br. 08/L-152 o antidopingu,
7. Drugo razmatranje N/zakona br. 08/L-072 o poljoprivredi i ruralni razvoj,
8. Drugo razmatranje N/zakona br. 08/L-145 o prevenciji i integrisanoj kontroli zagađenja,
9. Prvo razmatranje N/zakona br. 08/L-190 o balansiranom regionalnom razvoju,
10. Prvo razmatranje N/ zakona br. 08/L-185 o prevenciji i zaštiti od nasilja u porodici, nasilja nad ženama i rodno zasnovanog nasilja,
11. Parlamentarna rasprava povodom Izveštaja Evropske komisije o Kosovu za 2022. godinu,
12. Razmatranje godišnjeg izveštaja Autoriteta civilne avijacije Kosova za 2021. godinu.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Në masë të madhe dinamikat kohore dhe puna e Kuvendit shumë po varet prej efektivitetit të mazhorancës.

I nderuar kryeministër,

E nderuar zëvendëskryeministre,

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Para se të fillojmë seancën, më kanë paralajmëruar që mund të kemi një mocion.

Po fillojmë me mocionin, më keni thënë për shkak të disa marrëveshjeve ndërkombëtare që doni t'i përfshini në rendin e ditës, nëse është ashtu, sepse me Rregulloren e re duhet qysh në fillim të seancës.

Fillimisht, të nderuar deputetë, e kemi:

1. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

A keni vërejtje në procesverbalet e mbajtura më 8 dhe 15 dhjetor të seancave tona? Nëse nuk keni vërejtje, i konsideroj të miratuara këto procesverbale.

Urdhëro, zonja Kusari-Lila, për paraqitjen e një mocioni.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për të gjithë kolegët deputetët,

Përfaqësues të Qeverisë,

Kryeministrin, zëvendëskryeministrat,

Ne sot në dakordim edhe me shefat e grupeve parlamentare propozojmë pika shtesë të rendit të ditës të seancës së re.

Fillojmë me propozimin e parë.

Në pajtim me nenin 53, paragrafi 1 nënparagrafi 2 i Rregullores së Kuvendit propozojmë plotësimin e rendit të ditës për seancë plenare, më 23 dhjetor 2022, si në vijim:

1. Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit në mes të Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Reformës së Sistemit të Ndhmës Sociale në Kosovë.

Kjo pikë të renditet si pikë e pestë e rendit të ditës.

Përmes këtij projektligji do ta ratifikojmë marrëveshjen e financimit Projekti i Reformës së Sistemit të Ndhmës Sociale në Kosovës në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Botërore.

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është përmirësimi i barazisë dhe përshtatshmërisë së rrjetit të sigurisë sociale në Kosovë dhe forcimin e sistemit për ofrimin e mbrojtjes sociale.

Arsyeshmëria për përfshirjen në rendin e ditës në ditën e sotme është për faktin se kësaj marrëveshje afati i fundit të hyrjes në fuqi si skadon dhe është 31 dhjetori i vitit 2022.

Prandaj, për shkak të rëndësisë dhe peshës që e ka, propozojmë që të futet në rend të ditës.

Mund t'i lexoj edhe dy të tjerat dhe pastaj t'i votojmë një nga një apo votojmë një nga një për përfshirjen në rend të ditës.

KRYETARI: Propozoji të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare.

MIMOZA KUSARI-LILA: Dakord.

Propozimi i dytë në bazë të pikës së njëjtë neni 53, paragrafi 1, nënparagrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, propozojmë plotësimin e rendit të ditës së seancës plenare më 23 dhjetor 2022 me propozimin si vijon:

Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së kredit për projektin “Korniza e qyteteve të gjelbra dy, dritarja dy, eficientia e energjisë në ndërtesa publike në Prishtinë” ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Kjo të renditet si pikë e gjashtë e rendit të ditës.

Ndërsa propozimi i tretë, në bazë të nenit 53, paragrafi 2, nënparagrafi 2 të propozohet plotësimi i rendit të ditës me:

Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë për projektin “Eficientia e energjisë në ndërtesa publike në komunën e Prizrenit” ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Kjo marrëveshje të renditet si pikë e shtatë e rendit të ditës sot.

KRYETARI: Tri marrëveshje ndërkombëtare propozohen për rend të ditës.

Grupet parlamentare, zoti Tahiri, urdhëro, fjalën nga PDK-ja.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike do t'i votoj që këto tri marrëveshje të jenë pjesë e agjendës tonë legjislative sot, pavarësisht që ne sa i përket marrëveshjes së parë i kemi dilemat

tona. Ju e dini që në të kaluarën nuk i kemi votuar, mirëpo sa u përket dy marrëveshjeve të tjera do t'i votojmë. Dhe për këtë të parën na duhet edhe një konsultë shtesë, ne do të marrim vendim.

KRYETARI: Tash po votojmë vetëm a t'i përfshijmë a jo, kjo është çështja. Pastaj kur të vijmë aty, do t'i kalojmë një herë deklaratimet jashtë rendit të ditës, pyetjet parlamentare pastaj vijmë te këto tema.

Urdhëroni, zoti Gashi nga Lidhja Demokratike.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Marrëveshjen e parë, pra pikën e parë të propozuar për të futur në rend të ditës Grupi Parlamentar i LDK-së nuk e përkrah. Faleminderit!

KRYETARI: Kur jemi të LDK-ja, LDK-ja e paska ditëlindjen. Ju urojmë ditëlindjen tuaj! Jetë të gjatë e të lumtur politike!

Nuk është paraqitur AAK-ja.

Kjo është për t'i përfshirë në rend të ditës këto tri marrëveshje. Kështu që e hedhim në votim këtë mocion.

80 deputetë janë të pranishëm.

Kush është për përfshirjen e këtyre marrëveshjeve në rend të ditës.

Mund ta bëjmë edhe ashtu një nga një.

Kush është për përfshirjen e marrëveshjes së parë e cila ishte Marrëveshja për reformën sociale apo jo: Reforma e sistemit të ndihmës sociale në Kosovë.

Kush është për përfshirjen e kësaj marrëveshje në rend të ditës?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

68 deputetë kanë votuar.

68 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, përfshihet kjo çështje në rend të ditës.

E hedhim marrëveshjen e dytë, marrëveshja e dytë ishte për Prishtinën.

Ratifikimi e Marrëveshjes së kredit për projektin "Korniza e qyteteve të gjelbra dy, dritarja dy, eficienta e energjisë në ndërtesa publike në Prishtinë" ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Kush është për këtë marrëveshje?
Kush është kundër?
Kush abstenon?

76 kanë marrë pjesë në votim.

Të gjitha votat ishin për, asnjë kundër, asnjë abstenim, kështu që përfshihet kjo marrëveshje.

Dhe marrëveshja e tretë është: Ratifikimi i Marrëveshjes së kredisë për projektin “Eficienca e energjisë në ndërtesa publike në komunën e Prizrenit” ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim që ta përfshijmë në rend të ditës.

Kush është për këtë marrëveshje që të përfshihet në rend të ditës?
Kush është kundër?
Kush abstenon?

72 deputetë kanë votuar.

72 vota për këtë marrëveshje që përfshihet në rend të ditës, kështu që ajo përfshihen në rend të ditës, asnjë votë kundër, asnjë abstenim.

Këto marrëveshje në rend të ditës përfshihen si pika e pestë, e gjashtë dhe e shtatë e rendit të ditës.

2. Deklarimet jashtë rendit të ditës

Ia japim fjalën në emër të Partisë Demokratike.
Vetëvendosja u paraqit tash në fund. Luan Aliu e ka fjalën.

LUAN ALIU: I nderuar kryetar i Kuvendit,
I nderuar kryeministër,
Të nderuar ministra,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,
Të dashur qytetarë,

23 vjet pas përfundimit të luftës në Kosovë fqinji ynë verior sërish nga kërcënon me luftë dhe me rikthim të forcave ushtarake, të cilat gjatë viteve '90 patën kryer gjenocid kundër popullit tonë dhe dogjën e shkatërruan pronën e pasurisë tonë.

Serbia nuk e do ekzistencën e shtetit të Kosovës dhe pavarësinë e saj. Në esencë ajo kërkon të vazhdojë luftën të cilën e humbi dekada më parë.

Mohimi i shtetit të Kosovës dhe i pavarësisë nga ana e Serbisë përbën kërcënim të vazhdueshëm jo vetëm për shtetin tonë, por edhe për vetë ekzistencën tonë.

Në veri të vendit paqja mbeti përherë e brishtë. Pakoja e Ahtisarit ishte kompromis më i dhimbshëm që na imponua nga partnerët ndërkombëtarë nën arsyetimin e gjetjes së zgjidhjes, përmes së cilës komuniteti serb në Kosovë t'i fitonte të drejtat e garantuara, të zgjeruara e të rezervuara, që nuk i hasim në asnjë vend të Evropës e më gjerë.

Integrimi i vërtetë i veriut nuk ndodhi as pas shpalljes së pavarësisë dhe as pas më shumë se një dekade dialog në Bruksel. Ajo që na u shpërfaq vazhdimisht ndër vite si normalizim e integrim i veriut me institucionet e vendit, ishte një farë kompromisi që bëhej me bandat kriminale të dirigjuara nga Vuçiqi.

Lloj-lloj marrëveshjesh tregtare, politike, edhe për të formuar Qeverinë e Kosovës bëhej me kriminelët si Radojçiq e Veselinoviq, të cilët edhe u pritën ngrohtësisht në Zyrën e ish-kryeministrit Haradinaj në blerje të qetësisë së veriut në vend.

Madje ish-kryeministri Thaçi kishte nënshkruar edhe marrëveshjen e 9 prillit të vitit 2013, duke garantuar se Forca e Sigurisë së Kosovës nuk do të dërgohej atje.

Pra, të nderuar deputetë,

E të dashur qytetarë,

Për 20 vjet tolerohej kontrabanda, lejoheshin zgjedhjet e Serbisë, dinari serb, targat ilegale të Serbisë me emërtime të qyteteve të Kosovës, mospagesa e tatime lokale e as qendrore, mospagesa e faturave të shpenzimeve të energjisë elektrike, uji dhe shërbime të tjera.

Të gjitha këto që i numëruam më lart përbëjnë mosushtrim të obligimeve kushtetuese e detyrimeve ligjore. Andaj, një situatë e tillë është e papranueshme për një shtet demokratik, evropian, prosperues, siç është Republika e Kosovës, ku sundimi i ligjit është i padiskutueshëm gjatë mandatit të Qeverisë Kurti.

Vendi ynë është vendi më demokratik e më progresist në regjion. Qeveria e Kosovës ka demonstruar vazhdimisht për përkushtim për bashkëbisedim e bashkëpunim me komunitetin serb në Kosovë dhe për një angazhim proaktiv të tyre në ushtrimin e rolit që u takon me Kushtetutën tonë.

Në drejtim të zgjedhjes së përfaqësuesve të tyre përmes zgjedhjeve të lira e të ndershme dhe të zgjedhurit e tyre të ulen pranë nesh në Parlament e në kabinetin qeveritar, në mënyrë që bashkë t'i marrin vendimet për qytetarët e republikës.

Fatkeqësisht fqinji ynë verior, bandat kriminale që sfidojnë sundimin e plotë të ligjit në veri të vendit për një kohë të gjatë madje po i mban peng qytetarët tanë të komunitetit serb, duke i frikësuar, rrëmbyer, kërcënuar, djegur pronat e tyre individuale dhe familjare.

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Agjencitë e sigurisë së vendit tonë po veprojnë me kujdes në veri të vendit, duke kuptuar edhe ndjeshmërinë ndaj situatës, por edhe duke u bashkërenduar me partnerët tanë perëndimorë. Për shkak të brishtësisë së situatës atje dhe të partneritetit me miqtë tanë, ne kemi toleruar disa herë shtyrjen e zbatimit të vendimeve tona. Megjithatë ne nuk kemi hequr dorë nga asnjë vendim që kemi marrë dhe asnjëherë nuk do të heqim dorë nga zbatimi i ligjit dhe obligimeve që dalin nga Kushtetuta e vendit.

Në asnjë pjesë të vendit tonë nuk do të tolerohet mungesa e zbatimit të ligjit, pa dallim etnie, feje apo regjioni. Republika e Kosovës është e përcaktuar për një të ardhme demokratike, prosperuese dhe evropiane.

Qytetarët nga komuniteti serb në veri të vendit janë qytetarë tanë dhe duhet të distancohen nga bandat kriminale dhe nga regjimi i Vuçiqit, i cili po i manipulon dhe po kërkon luftën.

Ne asnjëherë nuk do të tërhiqeni nga përkushtimi e zotimi ynë për të garantuar dhe ruajtur qytetarët tanë pa dallim feje, etnie, moshe e gjinie.

Më lejoni që në emrin tim personal dhe të gjithë deputetëve t' i falënderojmë zyrtarët policorë, doganierët, korrektuesit dhe familjet e tyre për disiplinën, moralin, lojalitetin dhe përkushtimin e tyre në zbatimin e ligjit e ruajtjen e shtetësisë së Kosovës në veri të vendit.

Në fund më lejoni të ritheksoj edhe një herë se të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës janë në gatishmëri, vigjilente dhe me detyra të veçanta në mënyrë që të mundësohet vendosja e paqes, e sigurisë, e ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë në vendit tonë.

Ne nuk jemi kundër qytetarëve tanë serbë që jetojnë dhe veprojnë në veri të vendit, por jemi kundër çdo bande kriminale që sfidon ligjin dhe rrezikon sigurinë e qytetarëve tanë atje. Faleminderit!

KRYETARI: Tash në emër të PDK-së, deputetja Eliza Hoxha.

ELIZA HOXHA: I nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të dashur qytetarë,

Duhet kurajë e madhe qytetare e njerëzore për ta synuar pozitën e të parës së vendit, sepse pa atë kurojë mbetesh thjesht vetëm një pozitë.

E në atë kurojë më së paku duhet zënë vend pikëpamje private dhe personale, sepse të jesh presidente e një vendi, është të jesh presidente e vendit dhe të gjithë qytetarëve të tij pa dallim.

Sikur ta kishim ditur që presidentja Osmani nuk manifeston asnjërën nga atributet kushtetuese që presidentja duhet të bashkojë, e jo të përçajë.

Ne si grup parlamentar vendosëm që të mos qëndrojmë në sallën e Kuvendit kur ajo zgjodhi t'u adresohet deputetëve në fund vit. Ishte një veprim politik i vetëdijshëm nga ana jonë, të cilit presidentja do t'i kishte humbur kuptimin sikur përkundër refuzimit tonë me plot arsye për ta dëgjuar, ajo të kishte folur për të vërtetat tona si vend e si popull, për vlerat tona civile, historike e politike, duke iu përmbajtur rolit të saj kushtetues, e jo shndërrimit të këtij roli në çështje krejtësisht private.

Por ajo në fjalën e saj nuk na ka zhgënjyer aspak. Prandaj, po nga kjo foltore, ku presidentja tha një mal gjërash të pavërteta, cilësimesh të pabaza e të padenja për një presidente që përfaqëson së paku si parim unitetin e popullin.

Dua të shfrytëzoj rastin për të bërë një bilanc pak më ndryshe për punën e sak këtë fund vit. Një bilanc për të cilën ajo do të duhej të raportonte, e të cilin e shmangu me vetëdije, duke e kthyer fjalimin e saj në shumicën e rastit më shumë për veten e saj se sa për vendin.

Gjatë vitit 2022 Republika e Kosovës nuk ka pasur asnjë njohje të re. Politika e jashtme është një ndër shtyllat kryesore që lidhen me pozitën e presidentes, asnjë angazhim konsistent, përveç deklarativ, nuk kemi parë nga presidentja për këtë çështje kardinale në forcimin e subjektivitetit tonë ndërkombëtar.

Ka dështuar plotësisht për ta ushtruar këtë rol. Për më tepër, ka dështuar në mbrojtjen e imazhit të Kosovës si shtet i konsoliduar dhe ka abstenuar nga çfarëdo lloj përballje në interes të vendit kur për vendin dhe të vërtetat tona flitet zyrtarisht e jo zyrtarisht nëpër qarqe brenda e jashtë Kosovës.

Asnjë qytetar i Kosovës nuk e ka të qartë se çfarë mendon presidentja për asnjë çështje serioze të interesit publik që ka ndodhur në Kosovë dhe për Kosovën gjatë vitit 2022, as për papunësinë, as për inflacionin, as për regresin ekonomik, as për energjinë, as për ikjen e mjekëve, as për ikjen e të rinjve, as për veriun.

Presidentja Osmani ka abstenuar komplet nga çështjet e interesit publik.

Kosova ka pasur ambicie për t'u anëtarësuar në Këshillin e Evropës si një hap të cilin edhe ne e kemi inkurajuar Qeverinë, po askush nuk e di se ku ka mbetur ky proces, ku është ndalur, kush po e pengon dhe çfarë ka bërë presidentja si garantuese e të drejtave kushtetuese që derivojnë nga konventat e Këshillit të Evropës për të zhblokuar këtë proces.

Nuk jemi as në Interpol, edhe përkundër nënshkrimit të Marrëveshjes Europol, as për partnerit për paqe me NATO nuk e kemi dëgjuar apo, në fakt, është përpjekur të jetë e zëshme vetëm për t'i treguar NATO-s, BE-së dhe Amerikës se sa e rrezikshme është Rusia dhe Putini.

Se si e ka shfrytëzuar pozitën e saj për çështje të karakterit privat, kjo është çështje etike vetëm e saj, për të cilën nuk dua të komentoj tutje, por se nuk e ka shfrytëzuar pozitën e saj për çështje të karakterit publik, kjo s'ka të bëjë me etikën, ka të bëjë me përgjegjësinë dhe rolin e saj që derivon edhe nga Kushtetuta.

Dhe kur jemi tek përgjegjësia, ajo me përgjegjësinë e saj ka mbajtur dhe mban peng institucionet e drejtësisë, i bie për çark shkeljes së Kushtetutës dhe shpall e anulon zgjedhje në kundërshtim me Kushtetutën.

Pra si përmbledhje, presidentja Osmani është dashur të raportojë pse s'ka njohje, pse s'ka anëtarësim në organizata, mekanizma ndërkombëtarë, pse s'ka rezultat në dialog, pse ka degradim të diplomacisë e shumë pse të tjera, për të cilat nuk kemi përgjigje nga ana e saj.

Po aq do të duhej të na rrëfente çka ka bërë për të mos pasur kaq shumë "pse" që ne i shtrojmë sot këtu. Ajo nuk dha përgjigje për asnjërën nga këto çështje vitale për të ardhmen e Kosovës.

Në fund në fjalën e saj presidentja Osmani kishte komentuar opinione për të cilat njihet tash e sa kohë dhe që provon t'u japë karakter shtetërorë si qëndrime të Kosovës.

Çdo e pavërtetë mbi Kosovën, për Kosovën dhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Zgjateni fjalën e deputetes që ta përfundojë fjalimin e saj.

ELIZA HOXHA: Faleminderit!

Çdo e pavërtetë për Kosovës, mbi Kosovën dhe për rrugën e lavdishme të Kosovës drejt lirisë e pavarësisë, me gjithë protagonistët e saj, kurrë s'do të bëhet qëndrim i shtetit. Pavarësisht se mund të jetë qëndrim i Vjosa Osmanit që sot mban pozitën e presidentes. Faleminderit!

KRYETARI: Kush e jep qëndrimin në emër të LDK-së, deputeti Anton Quni.

ANTON QUNI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për kryeministrin,

Kabinetin,

Të gjithë ju deputetë,

Media,

Qytetarë,

Nga kryetari i Kuvendit, zoti Konjufca, u theksua se sot është 33-vjetori i Lidhjes Demokratike të Kosovës, prandaj e shfrytëzoj këtë rast që në emër të kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zotit Abdixhiku, në emër të deputetëve të gjithë qytetarëve t'ju uroj këtë ditë. Nderimet më të mira për të gjithë ata që kanë jetuar dhe vepruar në kuadër të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Urime edhe për ata që janë rritur brenda LDK-së, e tani gjenden në partitë e tjera politike.

Tani më lejoni që t'i them disa fjalë në lidhje me situatën e tensionuar në pjesën veriore të Kosovës, me shpresën se nga kryeministri dhe Qeveria që ai udhëheq do të merren me konsideratë me qëllimin më të mirë.

Në Kosovë në distanca shumë të shkurtra po zhvillohen dhe përjetojnë disa ngjarje si të ishin dy botë të ndryshme. Në njërin hapësirë të Kosovës zhvillohet jeta dinamike në trafik, sheshe, tregje, institucione, kafene, e tjera, kurse në pjesën veriore të vendit thuajse në një botë tjetër rrugët janë të zbrazëta e të bllokuara. Banorët janë të frikësuar, kemi patrullime të kujdesshme të Policisë së Kosovës, po ashtu edhe patrullime të grupeve paramilitare të maskuara e të armatosur. Ku qetësia kohë pas kohe thyhet nga altoparlantët e alarmit, brohoritjet e grupeve, shpërthimet, breshëritë e tjera.

Dhe krejt në skajin e veriut të Kosovës një kontingjent i Policisë së Kosovës është i izoluar. Thuaj se dy javë është në pritje e në krye të detyrës. Ata janë të vetëdijshëm pse janë aty, për rolin dhe domosdoshmërinë që të qëndrojnë aty qoftë edhe deri në pafundësi.

Mirëpo, kujt i shërben kjo situatë? Kush e dëshironte një situatë të tillë, përgjigjja është e pastër si kristali, si loti: Serbisë dhe Rusisë. E kujt nuk i duhet një situatë e tillë? Edhe këtu është përgjigjja e pastër si kristali: Republikës së Kosovës dhe miqve perëndimorë.

Të nderuar deputetë,

Për ju që nuk e keni kryer shërbimin ushtarak apo nuk keni përvoja të tilla, të qenët të izoluar në mes të malit, në ambient armiqësor, qëndrimi i gjatë është stresues, shumë stresues. Është qetësi shurdhuese edhe për njësitë më elitare, pritja e gjatë është aq stresuese sa që nga vetë aktorët në disa situata gjykimi nuk është i drejtë.

Nuk po flas për ta dramatizuar situatën, por që nga të gjithë ne, e në veçanti nga kryeministri të kuptohet pesha e situatës së krijuar.

Kundërshtari i Republikës së Kosovës, njëherësh aleati tradicional e i përhershëm i Rusisë është i krijuar nga kurthet, operon me kurthe e jeton nga kurthet. Andaj, sot veç një detyrë e ka kjo Qeveri: të mos vazhdoj të bie më në kurthet e kundërshtarit, në sferën ushtarake të mbrojtjes, të sigurisë, të njohësh armikun, është detyrë, e rrjedhimisht përparësi e madhe.

Mendoj se ne e njohim më së mirë kundërshtarin e shtetit tonë e të demokracisë perëndimore. Së paku që një shekull, prandaj mund të bëhet e pafalshme nëse ne vazhdojmë të biem në kurthin...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ia shtoni një pjesë të kohës deputetit.

ANTON QUNI: Në kohë tepër më të vështira, ne kemi arritur që luftën tonë ta bëjmë jo vetëm të drejtë, por edhe të mençur, sepse shumë herë gjatë betejave në kurthet e ngritura nga ta, kanë rënë vetë ata.

Nuk kam dyshim se policët tanë janë në nivelin e detyrës, jo që atë ua kërkon kryeministri apo ministri i Punëve të Brendshme, po që të njëjtën gjë do ta bënin kushdo që qeveris Kosovën. Janë po të njëjtit policë që në të kaluarën nga vetë kryeministri e disa përkrahës të tij u dhunuan dhe u ofenduan, bile duke i krahasuar me primatët më primitivë, e që besa u bënin thirrje poshtëruese që të shkonin në Mitrovicë. Ja, tani ata janë atje, bile përtej Mitrovice, me skajin më të largët.

Janë atje për të kryer detyrën e tyre, të cilën po e kryejnë me profesionalizëm, nder e përgjegjësi. Janë atje se janë të profilit të lartë moral, profesional e atdhetar, të tillë kanë qenë gjithmonë dhe janë të tillë dhe sot.

Kanë qenë në krye të detyrës edhe kur i keni poshtëruar, janë në krye të detyrës edhe sot e do të jenë përherë. Ata sot janë krenaria e Kosovës.

Bazuar në situatën e krijuar, shtrohet pyetja: A ka pasur mundësi të tjera, të cilat nuk krijojnë tensione, rreziqe, incidente, bllokime, konflikte e të tjera. Po, ishte një kërkesë shumë

dashmirëse dhe e arsyeshme nga aleati ynë më i besueshëm, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e përkrahur fuqishëm nga partnerët evropianë. Keni durim 10 muaj, të merremi me esencën, burimin dhe thelbin e problemit, e jo me derivatet e problemit.

Ju, kryeministër, aleatëve e Kosovës iu përgjigjët me faza e faza, periudha e etapa e tjera.

Kryeministër, nuk forcohet miqësia me kushtet, me rata e me këste: je mik ose nuk je mik.

Kryeministër, mund të ndjehesh i pushtetshëm me opozitën, mund ta vazhdosh ta ushtrosh pushtetin me mospërfillje e cinizëm, me padëgjueshmëri e me popullizëm, mirëpo Kosova nuk është e Qeverisë, është e popullit, andaj këtu po flasim për Kosovën e të gjithëve.

Kryeministër nuk duhesh asnjë...

(Ndërprerja nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, një minutë, po t'i dhamë tre, që është pak si shumë për Rregulloren e Kuvendit. Urdhëroni, po është në ndërgjegjen tuaj.

ANTON QUNI: Nuk duhesh dhe nuk bën assesi, sepse Republika e Kosovës është storie e suksesi kombëtar e ndërkombëtar.

KFOR-i me mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë nuk janë këtu vetëm për menaxhimin e pasojave të krijuara, po edhe për parandalimin e situatave të vështira. Prandaj, nuk po të kërkojmë që t'i ndërtohet raportet e sinqerta të bashkëpunimit institucional me partnerët e Kosovës, sepse ato i kanë ndërtuar në kohë shumë më të vështira presidenti Rugova, por po të kërkojmë që t'i mirëmbash e mos t'i luhatësh më ato.

Krejt në fund, ne ashtu siç jemi deklaruar edhe më herët, jemi unik të përballemi me të gjitha rreziqet që burojnë nga Serbia e Rusia. Të mbështesim me veprimet institucionale për sundimin e rendit dhe ligjit, po gjithnjë në bashkëpunim të sinqertët...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ju lutem, deputet, kjo është një format pesëminutësh i fjalimeve, nëse keni mundësi ta kontrolloni kohën tuaj.

Një minutë e bëjmë kështu ndonjëherë, po më shumë pastaj krijohen probleme prej grupeve të tjera parlamentare.

Kush e jep qëndrimin e AAK-së. Bekë Berisha, urdhëroni!

BEKË BERISHA: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

E dini që situata në vend është serioze, po e shoh që këtu në Kuvend disa nuk e marrin seriozisht këtë punë. Ne jemi të zgjedhur të popullit e kemi për detyrë kombëtare demokratike t'i çojmë disa porosi prej kësaj foltore, po e shoh që prapë disa heshtin, por mandatin e kemi prej popullit edhe duhet të flasim.

Protestat e stilit të Gazimestanit e të Milosheviqit në Fushë-Kosovë janë metoda e shekullit të kaluar, ato as nuk e ndihmojnë zgjidhjen e problemit mes dy shteteve e dy kombeve, e as nuk e ndihmojnë qytetarin e cilido komunitet në Kosovë, pra Vuçiqi duhet t'i ndalë këto kopje të lodhëta të shekullit të kaluar, të stilit të kasapit të Milosheviqit, sepse as nuk na trembin e as nuk kanë kurrfarë efekti.

Kryeministër, po e shohim se situata në vend nuk është duke u përmirësuar, por duke u keqësuar çdo ditë. Policët e Kosovës i kemi andej, e dimë në çfarë gjendje janë e në çfarë kushte janë. Ata policë s'janë as të kryeministrit, as të askujt këtu prej nesh, as të partive politike, po janë të popullit, janë të vendit që me vullnetin e vet, po e kanë edhe detyrë, po e ndihmojnë dhe po mundohen të mbajnë rendin kushtetues në veri.

Unë do të jem i shkurtër, kryeministër, t'i duhesh të dalësh prej lugut që ta ka përgatitur Vuçiq. Unë përtoj të jap porosi, të cilat dihen, por komunikimi me NATO-n, me Amerikën, për siguri është i domosdoshëm dhe është detyrë e jotja, nuk ka të bëjë këtu me vullneti tënd. Faleminderit!

KRYETARI: Ia japim fjalën tash nga Partia Demokratike Elmi Reçicës.

Duhet të lajmëroheni Vetëvendosja, nëse e keni mendjen të flisnio, nëse jo, vazhdojmë.

ELMI REÇICA: Faleminderit, kryetar!

Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Kolegë të nderuar deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Mërgimtarë,

Të dashur kudo që jeni gjithandej botës.

Desha që t'u drejtohem mërgimtarëve tanë që tash këtë kohë sigurisht që ka filluar ardhja e tyre në vend për fundvit.

Desha t'i falënderoj për angazhimin dhe punën të cilën e ka bërë dhe janë duke e bërë, po veçanërisht desha dhe dua t'i falënderoj për remitencat, të cilat ata i sjellin këtu në Kosovë.

Në kohë të mira e në kohë të vështira mërgata jonë bujare, fisnike, nuk ka hequr dorë asnjëherë prej familjes dhe atdheut. Roli dhe kontributi i saj gjatë viteve të okupimit, po edhe të çlirimeve dhe shtetndërtimit është i madh, i pakontestueshëm dhe i vlerësuar. Për këtë ne u jemi mirënjohës për jetë.

Përtej kësaj, është ndjeshmëria e secilit mërgimtar e mërgimtare ajo që Kosovën e mban gjallë në aspektin social dhe ekonomik. Aq më tepër, në kohë të krizave të veçanta dhe ato kriza kanë qenë jo të rralla.

Shkas i këtij adresimi është sasia e madhe e parave që sjell mërgata jonë dhe që ka sjellë përgjatë gjithë viteve. Që nga viti 2007, sipas statistikave zyrtare, mërgata jonë ka sjellë 11 miliardë e 389 milionë euro në Kosovë.

Kur i përmend këto shifra, mund të them që është dyfishi gjithmonë, nëse i kanë sjellë 12 miliardë që janë të regjistruara, janë 24 miliardë, sepse nuk llogariten ato para që jepen në dorë që i bënë shpenzime e ngjallet jeta në vend, të gjitha poret e shoqërisë kur vijnë mërgimtarët tanë ngjallen.

Nëse për këto vite ka pasur aq para dhe kanë sjellë aq të mira vendit, sigurisht që do të duhej të gjithë ne të jemi mirënjohës. Mendoj që edhe Qeveria dhe kryeministri do të duhej ta dëshmojnë më shumë këtë mirënjohje në raport me mërgatën tonë dhe mërgimtarët tanë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Nëse mund ta mbyllni fjalimin tuaj, zoti Reçica, urdhëro! Një minutë për zotin Reçica.

ELMI REÇICA: Nuk dua të zgjatem më shumë, po kisha pasur dëshirë që këto remitenca Qeveria e zotit Kurti të krijojë hapësirë dhe mundësi që të mos vijnë vetëm për shpenzime ditore dhe për ato çka janë të domosdoshme për nevoja familjare, po të krijohen mundësi, të ndryshohet Ligjit për investime strategjike, ku mërgimtarët tanë do të jenë me prioritet.

Së fundi, dua që të gjithë besimtarëve katolikë t'u uroj Krishtlindjet, meqë janë nëse në mesnatë, të gjithë mërgimtarëve tanë që vijnë për fund viti t'u uroj qëndrim të këndshëm në Kosovë dhe njëkohësisht t'u uroj Vitin e Ri, po besoj që viti i ri do të duhet të fillojë ndryshe nga ky vit që ka filluar dhe nuk do të duhej të përsëritej ajo çfarë është duke ndodhur në...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Fjalën ia japim deputetes Shqipe Isufi.

SHQIPE ISUFI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Më 15 dhjetor të këtij viti, saktësisht një javë më parë, patëm një ditë historike për vendin tonë, për qytetarët tanë në të cilën datë kryeministri Kurti dorëzoi zyrtarisht aplikimin e Republikës së Kosovës për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Gjithashtu zhvillim tjetër me shumë rëndësi në proceset tona integruese është ai i datës 20 dhjetor, kur ambasadorët e BE-së miratuan tekstin për liberalizimin e vizave për Kosovën, i cili do të hyjë në fuqi më së largu më 1 janar 2024.

Të dashur qytetarë,

Me aplikimin për anëtarësimin në BE, Qeveria e Kosovës i dha një rikonfirmim orientimit dhe perspektivës evropiane, duke shënuar kështu fillimin e një kapitulli të ri të marrëdhënieve me Unionin Evropian.

Data 15 dhjetor bart në vete të gjitha ato vite shpresë dhe ëndrra të qytetarëve tanë, të cilët ndër breza kanë ëndërruar dhe punuar për një ditë të këtillë.

Pra, është një momentum që flet për aspiratat e një vendi paqedashës për t'iu bashkuar familjes së madhe të shteteve demokratike, me të cilat ndajmë vlera dhe ideale të përbashkëta, sepse historikisht dhe pa asnjë dyshim populli i Kosovës ka treguar përkushtim të palëkundur ndaj këtyre vlerave, për lirinë, demokracinë, të drejtat e njeriut, barazinë dhe sundimin e ligjit.

Kryeministri ynë e ka theksuar më parë se ne duam të ndërtojmë Bashkimin Evropian në vendin tonë, me njerëzit tanë. Progresi i vendit lidhet me hapa që shënojmë në avancimin e demokracisë sonë.

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Progresi i mëtutjeshëm do të varet nga ne, ai bazohet në përkushtim dhe angazhimin tonë në kryerjen e detyrave dhe arritjen e standardeve të kërkuara. Ne do të ecim përpara vetëm në bazë të aftësisë sonë për të përmbushur kriteret në secilin kapitull të ri.

Të gjitha sfidat dhe pengesat drejt anëtarësimit i kalojmë me zhvillim demokratik dhe me progres shoqëror.

Kjo tanimë është dëshmuar me këto dy vjet qeverisje që kur besojmë në vlera e qëllime të drejta, çdo gjë është e mundur. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën ia japim deputetit Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Të nderuar qytetarë të Kosovës,
Kolegë deputetë,

Dje kemi shprehur shqetësimin tonë të thellë për rastin tragjik që ka ndodhur me foshnjën e pajetë në spitalin e Pejës, të cilin e cilësojmë si një krim i rëndë dhe për më keq, krim i cili është tentuar të fshihet nga pushteti për tetë ditë.

E kemi thënë në vazhdimësi se kjo Qeveri, e cila i ka prodhuar tre ministra të Shëndetësisë për dy vjet, përfshirë edhe Kurtin, si të vetëmëruar e të vetëvendosur për ta drejtuar sektorin e shëndetësisë, ka arritur kulmin e dëmtimit në sektorin e shëndetësisë.

Për foshnjën e pajetë që pretendohet që është futur në rrobalarëse me çarçaf në Spitalin e Pejës, i ka kaluar të gjitha limitet, është tepër i rëndë, është i frikshëm, është kulmi i krimit, ndërsa fshehja e rastit nga pushteti përgjegjës është krim makabër.

Ajo që u bë e ditur Spitali i Pejës e ka njoftuar Ministrinë e Shëndetësisë dhe Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, mirëpo këta të fundit për tetë ditë me radhë e kanë fshehur këtë rast të tmerrshëm, duke u bërë kështu edhe bashkë pjesëmarrës në këtë krim të supozuar. Dy ditë më vonë ushtruesja e detyrës së shërbimit spitalor ishte në vizitë në spital, por ajo u pa e buzëqeshur, sepse mashtruesit tentojnë ta mbulojnë dështimin me buzëqeshje, ashtu edhe krimin.

Prandaj, këta njerëz duhet të shkarkohen e të dënohen menjëherë, të gjithë ata që janë përgjegjës për këtë krim, përfshirë ata që e kanë fshehur këtë ngjarje të tmerrshme e të paprecedentë.

Kryeministri Kurti është i pari që duhet ta shkarkojë veten nga pozita e drejtuesit të shëndetësisë.

Kryeministër, pas këtij dështimi tënd të faktuar, së paku mundohu ta emërosh një ministër të Shëndetësisë, atë sa më parë, ndonëse tash edhe kërkesat ndaj jush i kemi të bazuara, ai apo ajo ministre e mundshme që paku të mos e dëmtojë më tej shëndetin e qytetarëve, së paku të mos investojë më tej në ikjen e mjekëve dhe profesionistëve shëndetësorë nga vendi.

Së paku të mos i lërë pacientët pa marrë shërbime shëndetësore si pasojë e mungesës së mjekëve dhe barnave dhe assesit që t'i lejojë të ndodhë apo të tentojë të fshehë ndonjë krim eventual se paaftësia e Qeverisë e dëmton rëndë shëndetin, ne këtë e kemi thënë me kohë. Sot po e përjetojnë të gjithë. Mirëpo rasti i foshnjës shkon përtej, sepse është tentuar të shihet krimi nga përgjegjësit që janë në vartësi të këtij pushteti të paaftë.

Dorëheqja e këtyre përgjegjësve është e vonshme, shkarkimi i këtyre është i domosdoshëm, ndërsa dënimi i merituar i bazuar në ligj duhet të jetë i pashmangshëm.

Mos të harrojmë se jo shumë ditë nga sot në duart e shtetit që menaxhohet nga ky pushtet i paaftë u vra edhe një nënë, e cila pritej që të sillte fëmijën e saj në jetë. Çmimi i paaftësisë së Qeverisë është bërë i papërballueshëm edhe në sektorin e shëndetësisë.

KRYETARI: Tash ia japim fjalën deputetes Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Kryeministër, po më vjen mirë që po ke kohë që dy ditë të qëndrosh këtu ulur dhe të dëgjosh këto llafe edhe ku po trajtohen, për besë po më duket që jemi duke jetuar në Zvicër a në Amerikë, edhe po më çudit kjo qetësia jote, po mendoj se është duke u zbatuar rendi e ligji në krejt Kosovës, po mendoj që s'ka barrikada ose po mendoj që atë realitet që po e shoh, është një ëndërr e keqe, se kur po vij këtu në Parlament e po të shoh duke qëndruar qetësisht, për besë po çuditë me ju. Ndoshta kjo është dëshira juaj që e keni pasur ta bëni këtë vend 'llugë' dhe t'i bëni shërbim Vuçiqit, e tash po rrini qetë, sepse e ke realizuar atë dëshirë të Vuçiqit. E tash, në vend që Kosova të jetë një vend që trajtohet dinjitetshëm, Kosova po shihet si fajtores me kriza të krijuara dhe të prodhuara nga ju.

Pa dyshim që dua t'ju lidh pak edhe me rastin që e tha edhe deputeti, për rastin e ndodhur në Pejë. Ne ndjejmë keqardhje për rastin që i ka ndodhur asaj familje. Mirëpo ju, kryeministër, mashtrues, edhe në këtë rast e gjeni një viktimë për ta shkarkuar. Unë e kuptoj zinxhirin udhëheqës dhe zinxhiri udhëheqës në spitalin e Pejës është zbatuar ashtu siç duhet, prej mamive të suspenduara, prej punëtorëve të pastrimit, ndërsa ju e gjet viktimë një ushtrues detyre të kryeinspektorit për ta shkarkuar për rastin. Po çka ka lidhje kryeinspektori me rastin e ndodhur. Unë kam punuar si kryeinspektore dhe e di cila është detyra e Inspektoratit të Shëndetësisë.

Ai raport ku është një rast specifik, inspektorët shkojnë edhe e trajtojnë rastin, hartohet një raport, kryeministër, me rekomandime në bazë të konstatimeve dhe ai raport CC i shkon edhe kryeinspektorit nga inspektori, edhe ushtrueses së detyrës të ministres. Atëherë pse u fsheh nga ushtruesja e detyrës së ministres rasti dhe këtë rast duke dashur ta kursesh një person politik, ju e keni gjetur një viktimë ushtruesin e detyrës së kryeinspektorit, gjë që keni bërë gabim, nuk i keni larë hesapet ose nuk mund të shkarkoheni prej përgjegjësisë që e keni shkarkuar një kryeinspektor që s'ka lidhje me hierarkinë.

Pse e kurseve kryeministrin, apo deshe me një udhë t'i kryesh dy punë që ta shkarkosh një ushtrues të kryeinspektorit dhe në vend të tij ta vendosësh një mjeke, e cila s'e ka asnjë ditë përvojë menaxheriale, duke e bërë kryeinspektorë. Mos mashtro opinionin, ke mashtruar edhe me rastin e shkarkimit të kryeinspektorit, sikurse ke mashtruar me të gjitha rastet deri sot.

Shkarko ushtruesen e detyrës së ministres, e jo kryeinspektorin, sepse nuk e ka asnjë përgjegjësi, s’e ka pasur asnjë përgjegjësi, sepse mbase...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Haxhi Avdyli.

HAXHI AVDYLI: Të nderuar kolegë,

Meqenëse në këtë Parlament në javën e kaluar na kanë munguar deputetët, të cilët nuk e kanë dëgjuar fjalimin e presidentes, unë i rekomandoj që ta gjejnë në You Tube ose ta gjejnë me shkrim dhe ta lexojnë edhe një herë dhe ta shohin se çfarë arritje të mëdha dhe sa ka qenë numri i madh i takimeve të presidentes me të gjithë aktorët e nevojshëm dhe të gjithë aktorët e politikës botërore që gjenden sot në botë nga presidenti Bajden, te presidenti Shollc, ai Macron, Erduan, e të gjithë presidentët e gjithë globit. Se puna e saj flet dhe nuk ka nevojë që ne sot të flasim dhe këtu të prezantojmë fakte, sepse kur janë faktet, fjalët janë të tepërta. Këtë e dëshmojnë edhe barometrat e ndryshëm, të cilët për presidenten Osmani vendosin si personin më të pëlqyeshëm në Kosovë, ku 59% të akredituarve sipas barometrit të sigurisë së Ballkanit Perëndimor janë të kënaqur me punën e saj. Ndërsa në aspektin e institucioneve të sigurisë e vendosin në 83% të kënaqshmërisë për punën e saj.

Prandaj, gjithë kjo punë po kurorëzohet edhe me rezultate të shumta në skenën globale, ku sot Kosova nuk është temë, por është palë, sot Kosova ka arritur për herë të parë që të realizojë atë të cilën është tentuar dhe janë çelur shampanja në të kaluarën, për liberalizimin e vizave, sot është marrë vendimi këto ditë dhe liberalizimi do të vijë shumë shpejt, jo si në të kaluarën që është thënë shumë shpejt, por është me datë të caktuar. Sot Kosova është në hapin e fundit drejt anëtarësimit në Këshillin Evropian dhe në shumë organizata të tjera dhe kjo është fryt i punës së mirë të presidentes, të kryeministrit, të ministres së Punëve të Jashtme dhe të gjithë aktorëve të tjerë.

Ndërsa aventurat në të kaluarën, të cilat janë bërë shpeshherë edhe me territorin e Kosovës, e kanë penguar edhe në njohje, edhe në anëtarësim, të cilat janë dashur të vinin edhe në të kaluar, por nuk kanë ardhur dhe tash po fillon që këto fryte të dalin falë kësaj punës të përditshme në takime, me aktorët vendimmarrës botërorë. Faleminderit!

KRYETARI: I fundit nga diskutuesit është Bekim Haxhiu dhe kalojmë te pyetjet parlamentare. Jo, s’ka më, bile edhe Bekimi është pak jashtë kohe, po me një mirëkuptim.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Unë edhe i kam paraprirë kohës. Mirëpo faleminderit për mundësinë dhe për temën.

Skandal pas skandali, keqpërdorim pas keqpërdorimi në sektorin e shëndetësisë dhe askush nuk jep llogari as përgjegjësi dhe as ministër nuk kemi.

Skandali i fundit i gjymtimit të kufomës së foshnjës së vdekur në lavatriqen e Spitalit të Pejës u bë i ditur falë mediave, sepse drejtori i Spitalit të Pejës, përgjegjësit e SHSKUK-së, Ministrisë së Shëndetësisë dhe kryetari i Komisionit Ekzekutiv për Shëndetësi janë përpjekur ta fshehin këtë krim për tetë ditë.

Pasi nuk ka as dorëheqje morale, atëherë ftoj Prokurorinë e Kosovës të fillojë hetimet nga kryetari i Komisionit Ekzekutiv për Shëndetësi, deri te drejtori i Spitalit të Pejës për tentim të fshehjes së krimit.

Mungesa e përgjegjësisë dhe llogaridhënies është shndërruar në normalitet, në dukuri, shih rastin e vdekjes së fëmijës së palindur të Hamide Magashit para derës së Gjinekologjisë, asnjë veprim nuk kishte ndërmarrë për ta shpëtuar atë, të paktën të provohej një metodë cezariene, e shpikur mijëra vjet më parë. Por, dështimi ishte evident dhe përgjegjësi nuk kishte, u hesht si rast, sepse përgjegjësit nuk dhanë as dorëheqje morale.

U hesht bashkë me miliona euro keqpërdorime dhe po bëhet gati tre muaj që Ministria e Shëndetësisë nuk ka as ministër.

Po kërkoj nga ju, kryeministër, të jepni dorëheqje nga Komisioni Ekzekutiv për Shëndetësi, ta shuani atë komision dhe ta emëroni një ministër, sepse atë për çka e keni themeluar këtë komision, për të mbuluar dështimin në sektorin e shëndetësisë dhe për ta detyruar Rifat Latifin të japë dorëheqje, tanimë e keni arritur, mirëpo nuk keni arritur të përmbushni asnjë premtim, asnjë zotim tuajin në programin për shëndetësi, për çka unë do t'ju ftoj në një debat parlamentar në sesionin e ardhshëm dhe shpresoj deri atëherë që të kemi një ministër të Shëndetësisë, me të cilin do të debatojmë.

Po kërkoj përgjegjësi për skandalet dhe keqpërdorimet nga njerëzit që ju keni emëruar në shëndetësi, sepse kjo është e domosdoshme. Por sot nuk po ju pyes pse nuk ka reformë, por ka degradim, pse nuk ka hartim të strategjisë pas dy vjetëve, po ka hajni, skandale e zhvatje, pse nuk ka ligje të shëndetësisë, por ka udhëzime administrative për të bërë biznese në sektorin e shëndetësisë.

Shëndetësia, i nderuar kryeministër, më shumë është përgjegjësi se sa privilegj, është parandalim, është diagnostikim...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, zoti Haxhiu! Urdhëro!

BEKIM HAXHIU: Asnjëherë nuk duhet të trajtohet shëndetësia si biznes për grupet e interesit, ashtu siç po e trajtoni sot.

Kryeministër, kërko raportet e operacioneve të kryera në sektorin e shëndetësisë në shëndetësinë publike gjatë vitit 2021 dhe 2022 dhe krahaso ato me sektorin privat dhe do ta shohësh se si janë përgjysmuar operacionet në sektorin publik dhe si sa janë dyfishuar këto në sektorin privat. Këto shikojeni, kryeministër, sepse njerëzit që i ke emëruar në sektorin publik po punojnë për sektorin privat, për xhepat e tyre, për bizneset. Faleminderit!

KRYETARI: Katër minuta jemi jashtë kohës së paraparë me Rregullore, kështu që vazhdojmë me:

3. Pyetjet parlamentare

Valentina Bunjaku-Rexhepi nuk është këtu.

Floreta Zejnullahu ka pyetje për ministrin Sveçla, a dëshironi ta lexoni, ministrin nuk e kemi këtu, dëshironi kur ai të jetë këtu. Mirë.

Deputetja Ganimete Musliu ia bën pyetjen kryeministrit Albin Kurti.

GANIMETE MUSLIU: Veç ndaljami zërin Mufailit një herë, tani vazhdoj unë, se s'po mund të dëgjoj asgjë.

KRYETARI: Vazhdoni, vazhdoni pyetjen, kthejani sekondat në dy minuta, ju lutem, regjia.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar!

Në programin qeveritar, ndër të tjera, keni thënë se “do të mundësojmë banim të përballueshëm për 4 mijë familje, këtë synojmë ta arrijmë nëpërmjet programit 120 here 120 dhe 150 here 150, ku familjet përfituese do të bëhen pronarë të banesave me këste mujore prej vetëm 120 euro, respektivisht 150 euro për një periudhë kohore prej jo më shumë 150 muajve”.

Zoti kryeministër, a mund të na thoni neve qytetarëve të Republikës së Kosovës se ku jeni me këtë projekt, në cilën fazë?

KRYETARI: Fjala është e kryeministrit!

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: E nderuar deputete Musliu,
Në këtë drejtim Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka nënshkruar marrëveshje me International Financial Corporation për realizimin e një studimi se si të zbatohet ky projekt në mënyrën më të mirë të mundshme.

Pritet që ky studim të përfundon deri në fund të këtij viti, pra çështje ditësh dhe IFC-ja të na i dërgojë neve të gjeturat.

Ky studim i ka disa komponentë, ku, ndër të tjera, duhet të bëhet edhe një analizë e përfituesve potencialë, analizë e gjendjes së banimit në Kosovë, analizë e ligjeve në Kosovë, që lidhen me projekt, si dhe modelet më të përshtatshme për ta realizuar këtë projekt. Në bosht të këtij projekti pritet të jetë partneriteti publiko-privat.

Për realizimin e këtij projekti janë përzgjedhur pesë komuna: Prishtina, Prizreni, Gjilani, Peja dhe Mitrovica.

Është kërkuar nga komunat që të dërgojnë tokën komunale në dispozicion. Të dhënat përkatëse të vlerësimit të përgjithshëm të tregut të banesave të përballueshme në Kosovë janë mbledhur dhe raporti është finalizuar. Të dhënat janë mbledhur duke përdorur shënimet për nivelin e të hyrave individuale të të punësuarve në Kosovë dhe me të njëjtat është punuar për të caktuar mundësitë e blerjes së banesave nga ky program. Është me shumë rëndësi të përmendet po ashtu, që është gjetur një zgjidhje praktike për të vazhduar me projektin. Domethënë, projekti mund të zhvillohet në bazë të ligjeve ekzistuese në fuqi.

Rekomandohet që të krijohet një ligj i veçantë për banimin e përballueshëm, ose së paku kjo çështje të përfshihet në Draft-ligjin për banimin social, që tanimë është në dëgjim publik. Analiza dhe modeli financiar janë në fazën e fundit dhe do të përfundohen brenda disa ditëve. Modeli financiar do të strukturohet si një shabllon që mund të aplikohet për shumë lokacione, në mënyrë që të mund të përdoret për qytete shtesë.

Më duhet të theksoj që deri më tani vetëm Komuna e Pejës e ka siguruar një parcelë të mjaftueshme për këtë projekt. Sipas planit fillestar dhe sigurisht, në harmoni me planet urbanistike të qytetit, në Pejë mund të ndërtohen 339 njësi banimi. Modeli financiar është dizajnuar në mënyrë të tillë që të mund të përdoret për çdo lokacion, pra edhe në qytete të tjera.

Jemi duke u angazhuar maksimalisht, që potencialisht të sigurojmë parcela në komunat e tjera, të cilat do të mund të shfrytëzohen për këtë projekt. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Musliu, pyetje shtesë për kryeministrin?

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar!

Kryeministër, ju me shumë pompozitet e keni proklamuar këtë gjatë fushatës zgjedhore dhe tash po del që ju as nuk e keni idenë se si bëhet ky projekt, si realizohet. Vetë fakti që ju ende jeni në fazën e nënshkrimit të memorandumeve, vetë fakti që ju vetëm në një komunë të vetme, siç është Peja, keni arritur ta siguronit një pronë për këtë, çka nëse komunat nuk kanë pronë dhe nuk ndajnë pronë, kryeministër? Ku mbetet premtimi juaj? E para.

E dyta, krejt çfarë thatë, çështje ditësh është analiza, janë marrëveshjet e bashkëpunimit, po ku është projekti, kryeministër? Kur do të mund qytetarët e Republikës së Kosovës t'i kenë ato banesa? Thjesht, kur do të mund ata që të jenë brenda banesës, të paguajnë nga 120 euro në muaj? Sepse, është viti i dytë i qeverisjes suaj, që po përfundon, dhe ju ende jeni në fazën e analizave...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Jo. Veç e ke rastin e përgjigjes së dytë.

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: Për shumë hollësi, të cilat nuk mund t'i shterojmë përmes pjesës së pyetjeve parlamentare, mund t'i drejtoheni ministrit të linjës, Liburn Aliu, për Mjedis, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë.

Por, ajo që unë si kryeministër jua them, është se ne marrim kohë në planifikim dhe jo në ekzekutim. Ne dëshirojmë ekzekutim sa më të shpejtë, ndërkaq mendim e planifikim sa më të thellë. Është e kundërta e qeverisjeve të mëhershme, ku është marrë shumë pak kohë në planifikim dhe përgatitje, ndërkohë që ekzekutimi ka shkuar "tërkuzë", shumë gjatë. Prandaj, duhet më shumë të planifikojmë e të mendojmë, e më shpejt të ekzekutojmë.

Fakti që të gjitha komunat nuk na i kanë sjellë neve të dhënat mbi parcelat, nuk flet për Qeverinë, por flet për komunat. Dhe, ne jemi të interesuar që këtë ta bëjmë sa më shpejt, mirëpo nuk mund ta bëjmë ekzekutimin pa e kryer mirë planifikimin dhe përgatitjet. Nuk është e thjeshtë të ndërtohen banesa të përballueshme për çifte të reja, siç kemi thënë dhe të sigurohemi paraprakisht që në këtë krahurë kadastrale e ligjore që e kemi trashëguar të mos na shfaqen probleme të mëvonshme.

Ne dëshirojmë që tash t'i eliminojmë problemet, në mënyrë që kur të fillojë përcaktimi i lokacioneve e ndërtimi, atëherë ajo të mos zgjasë deri atëherë kur familjet e reja do të mund t'i gëzojnë ato banesa sociale.

Pra, edhe një herë po e theksoj, marrim kohë në planifikim, mendim dhe përgatitje, në mënyrë që ekzekutimi të jetë i shpejtë.

KRYETARI: Zonja Musliu, mund ta përmbyllni diskutimin nëse doni. E keni minutën e fundit.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar!

Kryeministri sapo u deklarua që s'e ka haberin as çfarë ka premtuar dhe as ku ka shkuar ky projekt.

Pyetjen parlamentare unë e kam bërë më 25 nëntor dhe ky ka pasur kohë të mjaftueshme për t'u informuar se ku është ky projekt, në cilën fazë ka shkuar. Dhe, për informatën tuaj, zoti kryeministër, për banesat, ose për banim social, fizibilitetin e kryen HABITAT-i. Prandaj, mos i mashtro qytetarët e Republikës së Kosovës. Ti veç sa e the, të thuash është ndryshe, të punosh është ndryshe. Prandaj, kujdes çfarë po flet, se fjala publike ka peshë. Mos i mashtro qytetarët. Dil thuaj që nuk e kemi as në rend të përfundoni një projekt të tillë, po ju kemi mashtruar. Kaq!

KRYETARI: Vazhdo me pyetjen tjetër, zonja Musliu, pasi që ishe në një hov të mirë: Deputetja po e bën pyetjen tjetër, po ashtu për kryeministrin Kurti.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar!

Pyetja e dytë për kryeministrin e Republikës së Kosovës është kjo:

Duke e ditur rolin e sekretarëve të përgjithshëm në institucionet e Kosovës, me theks të veçantë nëpër ministri, sot shumica e ministrive udhëhiqen nga ushtrues detyre të sekretarit të përgjithshëm.

Zoti kryeministër, a mund të na thoni, pse deri më tani i nuk keni emëruar sekretarët e përgjithshëm, por mbi dhjetë ministri funksionojnë me ushtrues detyre, ose siç e keni potencuar ju, me zëvendëssekretarë?

KRYETARI: Kjo ishte pyetja e deputetes. Kryeministri fjalën e ka.

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: Faleminderit për pyetjen, deputete Musliu!

Siç e dini, ligji aktual për zyrtarët publikë parasheh procedurat për rekrutimin e nëpunësve të lartë drejtues, duke filluar me hapje të konkurseve përbrenda shërbimit civil dhe vetëm kur ato dështojnë, atëherë hapen konkurset për kandidatët nga jashtë.

Bazuar në këtë ligj ne kemi emëruar në mbledhje të Qeverisë anëtarët e Këshillit Shtetëror për Pranim dhe ata kanë zhvilluar tashmë një numër të procedurave të rekrutimit. Disa nga këto procedura kanë dështuar për mungesë të kandidatëve, disa të tjera për shkak të tërheqjes së kandidatëve nga procesi i garimit. Një numër i tyre janë shpallur për aplikim edhe nga jashtë, ndërsa disa të tjera veçse kanë përfunduar dhe nëpunësit e lartë janë emëruar në pozita.

Për shkak se ligji në fuqi nuk e krijon mundësinë e zëvendësimit të anëtarëve të këshillit, anëtarë të cilët, mos të harrojmë se po ashtu kanë pozita drejtuese dhe detyra pune nëpër institucionet e tyre, në disa raste këshilli është obliguar t'i shtyjë disa nga proceset e rekrutimit. Ka pasur vonesa edhe për shkak të afateve mjaft të gjata të ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Megjithatë, siç e dini, ne e kemi miratuar tashmë në Kuvend, besoj e keni parasysh Ligjin për zyrtarët publikë, i cili është një fitore e madhe e këtij viti sa i përket shtetndërtimit demokratik në Kosovë, dhe ky ligj është baza për të krijuar një administratë publike profesionale, e cila përmbush detyrat e saj dhe kërkesat legjitime të qytetarëve.

Ndër të tjera, ky ligj parashih edhe përzgjedhjen ad hoc dhe përmes algoritmeve të anëtarëve të Këshillit Shtetëror për Pranim për procedurë rekrutimit. Kësisoj nuk do të ketë ngecje për shkak të numrit të madh të procedurave dhe të pasurit vetëm një këshill me pesë anëtarë të vetëm. Për më tepër, konkurset do të jenë të hapura që nga hera e parë edhe për ata që nuk janë pjesë e shërbimit civil, por që i përmbushin kushtet dhe kriteret e kërkuara.

Unë i ftoj profesionistët, brenda Shërbimit Civil, brenda vendit dhe nga mërgata, që të aplikojnë në konkurset që do të jenë të hapura dhe të përzgjidhen më të mirët. Pra, do të rritet numri i kandidatëve potencialë, do të rritet konkurrueshmëria dhe rrjedhimisht, edhe kualiteti në nivelin e nëpunësve të lartë drejtues. Faleminderit!

KRYETARI: Pyetje shtesë, zonja Musliu?

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar!

Prapë nuk mora përgjigje, kryeministër, sepse jeni mësuar veç të flisni e të mos thoni asgjë.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të dhëna janë këto deri në ditën kur unë e kam bërë pyetjen parlamentare, është me ushtrues detyre. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë me ushtrues detyre, Ministria e Drejtësisë me ushtrues detyre, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me ushtrues detyre, Ministria e Mbrojtjes me ushtrues detyre, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë me ushtrues detyre, Ministria e Ekonomisë me ushtrues detyre, Ministria e Administratës dhe Pushtetit Lokal me ushtrues detyre dhe gjithashtu, e kemi Ministrinë e Zhvillimit Rajonal me ushtrues detyre, janë nëntë. I ke në të dhënat tuaja zyrtare në ueb-faqe vetëm tri ministri që kanë sekretarë, dy ministri nuk kanë të dhëna fare në ueb-faqe.

Prandaj, mos...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Gane, kujdes! Mos m'u përziej në profesion, kur po thua "Mos filozof!", se të filozofosh nuk është bash kollaj. Si unë të të them ty "mos juridizo", a çka të të them? Kujdes! Vazhdojmë.

Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: Së pari, deputetja Musliu, nuk është e vërtetë që është ushtrues detyre në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Pra, ju po flisni kur i keni marrë të dhënat, po ku di unë kur i keni marrë të dhënat ju! Po, unë s'mund të di kur i keni marrë të dhënat ju! Shiko, unë i di shumë gjëra, por jo kur i keni marrë të dhënat ju. Pra, unë nuk e di kur i keni marrë të dhënat ju dhe nuk është e vërtetë që Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit është me ushtrues detyre. Pra, aty e kemi sekretaren permanente, zonjën Fadile Dyla.

(Debat nga salla)

Tjetra, ju më thatë që unë nuk ju përgjigja. Për besë, nuk është e vërtetë! Unë ju përgjigja juve sipas të gjitha kritereve racionale dhe të parlamentarizmit. Andaj, unë e kam veç një pyetje për ju. A dini të më kallëzoni çka ju kallëzova?

Pra, unë u përgjigja në pyetjen tuaj dhe unë ju tregova se cili është qëndrimi im dhe mendimi im. A dini ju të më tregoni tash çka ju tregova?

KRYETARI: Zonja Musliu, urdhëro!

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar!

Kërkoj ndjesë për shprehjen "filozofi", por e thashë këtë duke kuptuar që ky hajgarexhiu këtu 40% e elektoratit të tij...

KRYETARI: Kujdes, se ky është kryeministri, Gane!

GANIMETE MUSLIU: ... i ka quajtur analfabetë funksionalë dhe duke ditur që ata s'e marrin vesh, prandaj i thashë.

Ndërsa, pyetjen parlamentare më 25.11.2022 unë e kam drejtuar te kryeministri i Kosovës dhe ky hajgarexhiu këtu, i cili e ka bërë shtetin 'llugë', nuk i shiten më mashtrimet, nuk i shiten më rrenat, nuk i shiten më gënjeshtat. Ti je veç një hajgarexhi!

KRYETARI: Deputetja Mirlinda Sadiku, pyetje për ministrin Xhelal Sveçla. Ministri nuk është këtu, e nderuar deputete.

MIRLINDA SADIKU-TISHUKAJ: Përshëndetje, kryetar!

Kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Kolegë deputetë,

Unë do t'i drejtohem edhe me shkrim ministrit Sveçla, se e di që është i angazhuar me obligime shumë të rëndësishme për shtetin e Kosovës, sepse ka të bëjë me një objekt që është filluar që në 2018-ën e kurrë s'është përfunduar, prandaj do t'i drejtohem me shkrim për këtë pyetje.

KRYETARI: Deputeti Shemsedin Dreshaj e ka pyetjen për kryeministrin Albin Kurti.

SHEMSEDIN DRESHAJ: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,
I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë dhe qytetarë të vendit,

Pyetja për kryeministrin bazohet në faktin dhe në kërkesat e disa qytetarëve, që m'i kanë bërë drejtpërsëdrejti. Bëhet fjalë për individë të caktuar, të cilët janë mbi moshën 65-vjeçare, që janë shumë të interesuar që të kenë sigurime shëndetësore, pa marrë parasysh marzhën e pagesës.

Një kërkesë e tillë është refuzuar nga ana e kompanive të sigurimit, që funksionojnë në vend. Kjo ankesë po ashtu është adresuar tek Avokati i Popullit, i cili ka një vit e gjysmë që nuk ka dhënë përgjigje.

Pyetja ime është: Pse personat mbi moshën 65 vjeçe nuk e kanë këtë të drejtë për sigurime shëndetësore dhe si e shihni në strategjinë tuaj zgjidhjen për këta persona? Faleminderit!

KRYETARI: Fjala për përgjigje e kryeministrit Kurti.

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: Faleminderit, i nderuar deputet dr. Shemsedin Dreshaj!

Sipas Ligjit nr. 04/L-249 për sigurimin shëndetësor, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin nr. 08/L-042, të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës pa dallim kanë të drejtë në sigurime shëndetësore, qoftë të formës së obligueshme apo vullnetare. Specifikisht, neni 5 i Ligjit thotë se sigurimet shëndetësore në Republikën e Kosovës organizohen dhe zbatohen si sigurime shëndetësore të obligueshme dhe sigurime shëndetësore vullnetare.

Po ashtu, sipas nenit 8, paragrafi 1 i ligjit, qytetarët dhe banorët e Republikës së Kosovës, punonjësit e huaj në Republikën e Kosovës, si dhe të gjithë të tjerët kanë të drejtë të kenë sigurim shëndetësor vullnetar plotësues.

Pra ligji është shumë i qartë, se të drejtën e sigurimeve shëndetësore e kanë të gjithë qytetarët e Republikës. Tash, paragrafi 3 aty në po të njëjtin ligj thotë: "Sigurimi shëndetësor vullnetar

plotësues realizohet nëpërmjet kontratës individuale në mes të të sigurvearit vullnetar, ose përfaqësuesit të tij të emëruar ligjor, dhe kompanisë private të sigurimeve shëndetësore, në pajtim me ligjin”. Në këtë rast, qytetari që ka shprehur interes për sigurime shëndetësore i drejtohet kompanisë private të sigurimit për të nënshkruar një kontratë.

Tash sa i përket zbatimit apo jo të ligjit, ju rekomandoj që si organ mbikëqyrës i Bankës Qendrore të Kosovës, Kuvendi i Republikës, ajo është përgjegjëse për monitorimin e sektorit të sigurimeve, të kërkonte direkt përgjigje dhe informata më të detajuara lidhur me këtë çështje.

KRYETARI: Zoti Dreshaj, pyetja tjetër shtesë, nëse keni?

SHEMSEDIN DRESHAJ: Faleminderit, kryetar!

Jo, nuk kam pyetje shtesë. Vetëm desha ta ngre këtë çështje, për shkak se realisht kjo është duke ndodhur në të vërtetë. Fatkeqësisht, edhe nga institucionet neutrale të cilat duhet të japin ndonjë opinion, kjo nuk është duke ndodhur.

Pra, flas për një vit e gjysmë pritje për një përgjigje. Nuk është akuzë, por është që të gjithë të mendojmë të zgjidhim një problem, që aktualisht është “pending”. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Dreshaj, mund të vazhdoni, nëse doni, edhe me pyetjen tjetër që e keni për ministrin Aliu.

SHEMSEDIN DRESHAJ: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet Qeveritar,

Deputetë,

Qytetarë të vendit,

Një javë më parë, pra kjo pyetje ka pritur një kohë, dhe një javë më parë Policia e Kosovës ka prangosur dy vëllezër në Dugajevë të Rugovës, të cilët kanë qenë duke bërë renovimin e Kullës qindvjeçare, trashëgimi e stërgjyshit.

Ne e dimë që Rugova është krenaria e trojeve shqiptare, në veçanti e Kosovës. Sot ajo është e ngufatur me Ligjin e parkut nacional, ku shumë veprimtari normale e njerëzore sot atje janë të ndaluara.

Ju përkujtoj se kjo trevë pesë herë ka qenë komunë e ndarë dhe e vetëmenaxhuar, ndërsa nga viti 1976 është vendosur nën administrimin e Kuvendit Komunal të Pejës, ndërsa sot është në administrimin qendror, pra si Park Kombëtar.

Pyetja për ministrin Aliu është kjo: Kush i ka urdhëruar këta policë dhe pse?

Ingerencat për këto veprime kujt i takojnë, juve si qendër, apo Kuvendit Komunal të Pejës?

Në ndërkohë, ka ndodhur edhe një veprim tjetër në Bogë, në Stankaj dhe në Shkrel, ku janë ndaluar, ndërsa kjo pjesë sipas hartës zonale, ju e dini që i takon zonës së lirë të ndërtimit. Faleminderit!

KRYETARI: Përgjigjja e ministrit Aliu.

MINISTRI LIBURN ALIU: I nderuar deputet,

Ne jemi njoftuar për rastin.

Për sa u përket ndërtimeve që ndodhin brenda zonës të Parkut Nacional të Bjeshkëve të Nemuna, meqenëse akoma nuk është miratuar plani hapësinor i Parkut Nacional Bjeshkët e Nemuna, i cili është tash është draftuar, është kryer drafti dhe do të mund që në zoonimin e saj të mund të lejohen pastaj ndërtimet, besoj që edhe rasti në fjalë, meqenëse bëhet fjalë për vend ku ka tashmë ndërtim, që i bie ku ka vendbanim, jam i bindur që në atë zonë do të mund të procedohet me leje ndërtimore.

Për sa i përket, se kush ka urdhëruar Policinë për arrestimin, kjo nuk është në kompetencë të Parkut Nacional dhe të rojës së parkut.

Roja e parkut mund të bëjë një procesverbal për ndërtimin, eventualisht mund të bëjë kallëzim penal, por Policia e as Prokuroria nuk mund të pranojnë urdhra nga rojat e Parkut Nacional e as këta e kanë të drejtën t'i urdhërojnë ato.

Jo çfarëdo lloj veprimi që mund të bëhet në Parkun Nacional me rojën e pyllit, mund të përfundojë me urdhër nga ai për arrestim të dikujt. E shumta, mund të përfundojë me gjoba, kallëzime penale dhe vepra, të cilat dërgohen te institucione të tjera, që në këtë rast është Policia dhe Prokuroria.

Prandaj, unë mendoj se pyetja se kush e ka urdhëruar Policinë nuk mund t'i takojë Ministrisë që e drejtoj unë. Por, sa u përket kompetencave brenda Parkut Nacional, kjo punë do të rregullohet më tej me ligj, sepse kemi një kompetencë të përzier, pasi që ministria e ka autoritetin mbi parqet nacionale, por në anën tjetër, për objektet e kategorisë një dhe dy, që janë objektet e vogla, është kompetencë e komunave.

Kemi pasur kompetenca të përziera, të cilat mendoj se me ndryshimet në Ligjin e ndërtimit do t'i definojmë qartë, edhe sa i përket trajtimit të pyjeve, edhe sa i përket trajtimit të ndërtimeve brenda zonave të mbrojtura, që janë parqet nacionale.

KRYETARI: Zoti Dreshaj, pyetje tjetër për ministrin?

SHEMSEDIN DRESHAJ: Faleminderit, kryetar!

Jo. Vetëm desha një gjë të them. Unë nuk jam duke kërkuar asgjë tjetër, përpos asaj që ka qenë 300 vjet. Flas me kompetencë në këtë rast, që të ketë të drejtën e shfrytëzimit.

Pra, le të jetojnë njerëzit me njerëz e arushat me arusha. Nuk kam kurrfarë vërejtje në këtë kontest. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, Vazhdojmë me deputetin Bekë Berisha. Ai e ka një pyetje për ministrin e Bujqësisë, Faton Peci.

BEKË BERISHA: Faleminderit, kryetar!

Pyetja është kështu: Dëmet e shkaktuara nga breshri në Kosovë, a u kompensuan, ministër? Nëse jo, kur do të kompensohen? A u vlerësuan, sa janë këto dëme dhe kur pritet kompensimi i tyre?

KRYETARI: Fjala për ministrin e Bujqësisë, Faton Peci. Urdhëroni!

MINISTRI FATON PEÇI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar deputet,

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në konsultim me të gjitha komunat e Republikës së Kosovës ka përgatitur dhe aprovuar një udhëzues për kushtet, kriteret dhe procedurat e kompensimit të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore në fushën e bujqësisë.

Konstatimi i gjendjes në terren, evidentimi i dëmeve dhe përcaktimi i përqindjes së dëmit është realizuar nga komisionet komunale. Në analizën e bërë nga Ministria e Bujqësisë dhe pas përfundimit të punës, ministria ka proceduar kompensimin e dëmeve me vendim të Qeverisë për njëzet e dy komuna, duke përfshirë komunën e Deçanit, Drenasit, Ferizajt, Gjakovës, Gjilanit, Istogut, Junikut, Kamenicës, Leposaviqit, Lipjanit, Malishevës, Mitrovicës, Novobërdës, Obiliqit, Pejës, Podujevës, Prishtinës, Rahovecit, Shtimes, Skenderajt, Vitisë, si dhe komunës së Vushtrrisë.

Raporti i komisionit në Ministrinë e Bujqësisë, së bashku me të gjitha raportet e komisioneve komunale, janë proceduar për aprovim në Qeveri dhe janë miratuar në vlera monetare në 2 826 464 euro.

Tash që ne po diskutojmë në bazë të informacioneve që unë i posedoj, tashmë gjysma e tyre, do të thotë vlerës prej 1,8 milionë euro veçse janë proceduar dhe pjesa tjetër pritet që sot, ose nesër, të ekzekutohet në Thesarin e Ministrisë së Financave.

KRYETARI: A keni pyetje shtesë?

BEKË BERISHA: Ministër, faleminderit për përgjigjen.

Dikur mbrojtja nga breshri dhe vërshimet ishte më efikas se sot. Shtretërit e lumenjve mirëmbaheshin, vërshimet ishin minore, ndërsa breshri në kulturat bujqësore gati se nuk hetohej, pasi që përdoreshin topat për shpërndarjen e reve.

Ministër, dëmet qenkan kompensuar gjysma. Breshri dhe vërshimet po e dëmtojnë bukën e gojës. Cila është strategjia juaj për mbrojtjen nga breshri dhe vërshimet në të ardhmen?

KRYETARI: Urdhëroni, ministër.

MINISTRI FATON PEÇI: Faleminderit, kryetar!

Harrova në pjesën e parë të përgjigjes të them që në të kaluarën prej 20 - 30% ka ndodhur kompensimi i dëmeve, ndërsa për këtë vite kemi bërë kompensimin e 82% dhe, përveç kësaj, kemi pasur rritjen rekorde të përkrahjes për fermerët këtë vit, që vetëm në kategorinë e pagesave direkte kap vlerën prej 61,8 milionë euro, duke mos i mbetur asnjë fermeri, 28 010 fermerëve në nivel të Kosovës i kemi kompensuar për herë të parë Ministria e Bujqësisë të gjitha pagesat në kategorinë e pagesave direkte.

Çështja tjetër, sa u përket masave preventive, ne kemi hartuar një koncept dhe kemi marrë edhe praktika në Austri, po edhe në pjesën e Maqedonisë së Veriut, që parasheh mundësinë e masave preventive rreth rrezeve që vijnë kryesisht nga të reshurat, në këtë rast nga breshri. Janë disa çështje që duhet të qartësohen paraprakisht, e njëra prej saj është leja e KFOR-it të hapësirës ajrore. Por, sido që të jetë, gjatë vitit ne do të bëjmë përpjekje, qoftë përmes buxhetit vetjak, ose përmes institucioneve të tjera financiare për të parë mundësinë edhe të uljes së dëmeve, do të thotë nga aspekti i parandalimit.

Por, është e rëndësishme që ne në kuadër të programeve tona që i kemi, edhe në grante, edhe në pagesa direkte, kemi ofruar për dymbëdhjetë kultura bujqësore kompensimin e primës së sigurimit në vlerën 75%, që është më e madhja në Evropë, për blerjen e primës së sigurimit dhe kompensimin paraprak, do të thotë mundësisë së kompensimit për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore.

KRYETARI: Vazhdojmë. Deputetja Fejza tashmë e ka tërhequr pyetjen e saj. Është pyetja e nëntë. Pastaj, dalim te pyetja e dhjetë, është ajo e Njazi Isakut. Deputeti ia shtron pyetjen ministrit Sveçla. Ministrin nuk e kemi këtu.

NJAZI ISAKU: Faleminderit, kryetar!

Meqenëse, s'është ministri dhe e kërkoj një përgjigje afër dy muaj, ka rëndësi të veçantë për arsyen se bëhet fjalë për një shkollë në Pozharan, e që kanë filluar mësim nxënësit. Janë afër 500 nxënës që mësojnë në katër ndërrime, e që punëkryesi është prej 2016-ës, e që duhet pasur së

paku një përgjigje për qytetarët që na bëjnë presion neve. Çka është duke ndodhur? Kur po fillojmë? Çfarë masa kemi ndërmarrë ne si Qeveri?

Prandaj, meqenëse është seanca e dytë që vjen si pyetje, mendoj ta bëj me shkrim ndaj ministres?

KRYETARI: Po varet prej rrethanave, ndonjëherë më shpejt mund të merrni përgjigje me shkrim, nëse e ke ashtu.

NJAZI ISAKU: Ashtu bën, faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Mërgim Lushtaku, po ashtu e ka pasur një pyetje për ministrin. Nuk janë asnjëri këtu. Deputetja Labinotë Demi-Murtezi e ka pyetjen për ministren Haxhiu.

LABINOTË DEMI-MURTEZI: Faleminderit për fjalën, kryetar!

E nderuar ministre Haxhiu,

Në Komisionin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale kemi pasur në takim udhëheqësit e qendrave për punë sociale nëpër komuna. Nga ky takim kemi mësuar se që nga viti 2023 këto qendra punojnë dhe mbikëqyren nga Ministria e Drejtësisë. Jemi të vetëdijshëm se këto qendra kanë probleme të shumta funksionale mjaft komplekse.

E nderuar ministre,

Cila është strategjia juaj e punës dhe e ndryshimit në ngritje të cilësisë dhe efikasitetit në këtë sektor?

KRYETARI: Urdhëroni, ministre!

MINISTRJA ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Faleminderit për pyetjen, e nderuar deputete!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Së pari më lejoni t' ju njoftoj, që gjatë këtij viti kam takuar disa prej kryetarëve të komunave dhe vizitat do të vazhdojnë në vitin 2023.

Qëllimi i këtyre takimeve me kryetarët e komunave ka qenë pikërisht diskutimi mbi funksionimin e qendrave për punë sociale, sepse siç e dini, ka pasur një decentralizim para disa vjetësh dhe realisht kompetenca për funksionimin dhe kapacitetet e qendrave për punë sociale kanë lënë në kuadër të komunave.

Gjithashtu, kam vizituar disa prej qendrave për punë sociale dhe po ashtu, në kuadër të gjashtëmbëdhjetë ditëve të aktivizimit kundër dhunës në bazë gjinore, së bashku me kryeministrin

Kurti, ministrin e Punëve të Brendshme, kemi takuar të gjithë përfaqësuesit e qendrave për punë sociale për të kuptuar më tepër për sfidat dhe nevojat që i kanë.

Më lejoni t' ju njoftoj që gjendja nuk është aspak e mirë, për faktin se në qendrat për punë sociale, pavarësisht shërbimeve që i kryejnë më shumë se njëqind shërbime, ato kanë mungesë të kapaciteteve njerëzore, por edhe kapaciteteve profesionale. Prandaj, në diskutim që kemi pasur edhe me ministrin e Financave, ne jemi dakorduar që ka nevojë për një reformë tek qendrat për punë sociale, mirëpo kjo reformë do të nisë në vitin e ardhshëm, mundësisht në fillim të vitit të ardhshëm, ku bashkë me Ministrinë e Financave, Ministrinë e Punëve të Brendshme, po ashtu edhe atë të Arsimit, do të bëhet së pari një koncept-dokument për mënyrën se si funksionojnë qendrat për punë sociale dhe gjithashtu pastaj koncept-dokumenti do të na japë një pasqyrë të qartë për sfidat që kanë, nevojat që kanë dhe rrugën që duhet ndjekur.

Megjithatë, më duhet të theksoj që ky proces mund të zgjasë për faktin se nuk do të jetë fare lehtë që të adresohen të gjitha në një kohë të shpejtë. Megjithatë, me lejen e Ministrisë së Financave, apo ministrit të Financave, më lejoni t' ju njoftoj që Ministria e Financave, pra derisa të adresohet reforma, departamenti i politikave sociale dhe familjare me qëllim të fuqizimit të qendrave për punë sociale dhe shërbimeve sociale dhe familjare kanë hartuar dy projektligje, Projektligji për shërbime sociale dhe familjare dhe Projektligji për financa të pushtetit lokal, të cilat projektligje konsiderojmë që me aprovimin e tyre megjithatë do të adresohet problemi, të paktën në një masë, në fuqizimin e qendrave për punë sociale dhe po ashtu, në kuptim të ofrimit të shërbimeve.

Me Ministrinë e Financave jemi dakorduar që shërbimet e qendrave për punë sociale të mbeten në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe ideja për këtë ka qenë vetëm për shkak të kompetencave që kanë qendrat për punë sociale në raport me mbështetjen ndaj viktimave, ndërsa politikat të mbeten te Ministria e Financave.

Pra, për ta përmbyllur, vitin e ardhshëm ne planifikojmë që ta bëjmë një reformë tek qendrat për punë sociale dhe pastaj kjo reformë do të na mundësojë që qytetarët e Republikës së Kosovës të marrin shërbimet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Zonja Demi-Murtezi? Deputeti Visar Korenica ia drejton pyetjen e tij ministrit të Bujqësisë, Faton Peci. Urdhëroni, zoti Korenica!

VISAR KORENICA: Faleminderit, kryetar!

Pyetja ime lidhet pak a shumë me kolegun Bekë Berisha, lidhur me vërshimet që kanë ndodhur në muajin shtator.

Pra, siç e dini, shumë ekonomi familjare janë dëmtuar, po në theks të veçantë pjesa e sektorit të bujqësisë është prekur. Vetë ministri ka qenë në vizitë në disa prej vendeve nga rajoni i Dukagjinit, sepse atje kemi pasur më së shumti të prekur. Dhe, në këtë drejtim pyetja është e përcjellë nga hera e kaluar. Atëherë kur e kam bërë pyetjen, kam kërkuar të di deri ku ka shkuar vlerësimi i komisionit, por në ndërkohë ka ndodhur që është marrë një vendim nga ana e Ministrisë, që shuma prej 2.8 milionë eurove të kompensohet.

Nëse nuk gaboj, diku rreth 70% e shumës totale që ka prezantuar drejtoria komunale nga Komuna e Rahovecit është mbuluar dhe një pjesë tjetër ka mbetur të riaplikohet përsëri, pas ankesave besoj, po prej çështjeve që e kam parë ndoshta si mangësi është bashkëpunimi midis komisioneve të Qeverisë dhe ndërkomunale, pra për ta vërtetuar dëmin, se shpesh ndodh që raportimet janë të pasakta dhe shumë bujq mbesin pa u kompensuar.

Por, njëkohësisht më intereson edhe strategjia e Qeverisë sonë, pra e Ministrisë së Bujqësisë, sa u përket preventivave, parandalimeve të vërshimeve nga lumenjtë, të cilët vazhdimisht janë të bllokuar dhe për pasojë, kemi dëme shumë të mëdha nëpër ara e fusha, ku bujqit tanë i punojnë.

Për këtë është një kosto e madhe për Republikën e Kosovës, le të themi për pesë vjetët e fundit minimumi, nëse llogarisim nga tre milionë euro, diku rreth pesëmbëdhjetë milionë euro është dëmi. Pra...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Urdhëro, ministër!

MINISTRI FATON PEÇI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar deputet,

Unë dhashë një përgjigje paraprake rreth ecurisë dhe kompensimit. Do të thotë, 2.8 milionë euro tashmë janë të aprovuara dhe në fazën finale të ekzekutimit, ndërsa rreth masave preventive që duhet ndërmarrë në nivel të lumenjve, mendoj që ky është një proces kompleks gjithëpërfshirës që duhet pasur qasje edhe ndërsektoriale, po duhet qenë edhe nivelet komunale të përfshira, për të mundur të identifikohen se cilat janë zonat ku kanë potencial, ose duhet të intervenohet, në mënyrë që të sanohen ose të merren masa parandaluese në përsëritjen e këtyre vërshimeve, ose dëmeve në sektorin e bujqësisë, po edhe në sektorë të tjerë.

Sa i përket sektorit të bujqësisë, tashmë kjo dihet, po përveç kësaj Qeveria në shtator me vendim qeveritar ka themeluar edhe një grup punues ndërsektorial të të gjitha ministrive, në të cilën do të bëhet pjesa e vlerësimit dhe të kompensimit të dëmeve edhe për ekonomitë e tjera familjare, jo vetëm në sektorin e bujqësisë.

Ndërsa, sa i përket bashkëpunimit që duhet, nevojës që ti e shtrove, që të ketë bashkëpunim më të mirë në mes komisioneve komunale dhe ministrisë, ne e japim pjesën e përgjegjesisë, në këtë rast të Ministrisë së Bujqësisë që unë e përfaqësoj, ne në afat rekord i kemi trajtuar të gjitha vlerësimet, ose materialet që kanë ardhur. Por, njëkohësisht edhe e kemi evituar një vërejtje paraprake të auditorit, në të cilën kërkohet shumë më specifikisht për secilën lëndë të proceduar se cilat duhet qenë materialet e bashkëngjitura.

Kështu që, çfarëdo materiali që nuk i është bashkëngjitur, ose nuk kompensohet në vlerën totale të kompensimit të secilit fermer, pjesa dërmuese ose pjesa kryesore u takon komisioneve komunale, për shkak se nuk mundet ministria për të gjitha komunat t'i bëjë vlerësimet, në mungesë edhe të resurseve humane. Faleminderit!

KRYETARI: A keni pyetje shtesë, zoti Korenica?

VISAR KORENICA: Po, kryetar! Një ndërhyrje.

Duke pasur parasysh që vazhdimisht çdo vit gati po përsëriten vërshimet, se nuk është në dorë të njeriut, kjo është në dorë të Zotit, po megjithatë ne jemi këtu për të marrë masa e veprime që të mos ndodhin dëme të mëdha. Ndërveprimi institucional i nivelit qendror me atë lokal është i pashmangshëm. Është ndoshta më mirë të shpenzohen në kapacitetet rregulluese një milion euro brenda një viti, sesa të shpenzohen tre apo katër milionë për një dëm, i cili përsëritet çdo vit.

Kërkoj si deputet, që tokat bujqësore të kenë prioritet, sepse po bëhet dëm i madh në dy nivele. Niveli i parë, për arsye se po përsëritet një dëm dhe ne si Qeveri dhe si...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Burim Meta, pyetje për ministren Arbërie Nagavci.

BURIM META: Përshëndetje, kryetar!

Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

E nderuar ministre,

Kemi një ankesë nga studentët e Universitetit “Kadri Zeka” të Gjilanit, të cilët nuk janë përfshirë në mundësinë e përfitimit nga mbështetja me bursa, që bëhet nga SEMS-i.

Ju lutem, nëse kemi një përgjigje nga ju, se përse vetëm ata studentë janë përjashtuar nga kjo mundësi e përfitimit? Faleminderit!

KRYETARI: Ministrja Nagavci, urdhëroni!

MINISTRJA ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar deputet Meta, faleminderit për pyetjen!

Ka qenë një vendim i komisionit që tri programet e matematikës arsimore në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan dhe në një universitet tjetër po ashtu, fillimisht të mos përfshihen. Megjithatë, janë shqyrtuar kërkesat dhe ankesat respektivisht dhe bazuar në listën e programeve të akredituara nga Agjencia Kosovare e Akreditimit, është lejuar mundësia për aplikim në formën on-line dhe janë shqyrtuar të gjitha kërkesat, edhe të studentëve të matematikës arsimore që i plotësojnë kriteret për aplikim.

Komisioni i MASHT-it besoj që e ka finalizuar punën dhe shumë shpejt publikohen listat, duke i trajtuar edhe këto çështje që ju i adresuat. Faleminderit!

KRYETARI: Kjo ishte përgjigjja e ministres. Vazhdojmë me pyetjet e tjera. Ganimete Musliu nuk është këtu. Deputeti Elmi Reçica pyetjen ia drejton ministres së Arsimit, po ashtu.

ELMI REÇICA: Faleminderit, kryetar!

Zonja ministre, e keni marrë pyetjen me shkrim, por do ta lexoj edhe me gojë, për hir të rregullave dhe të opinionit.

Çështja ka të bëjë me shkollën fillore dhe të mesme të ulët “Gjon Serreçi” në Ferizaj. Pyetja: Pse janë duke ndodhur vonesat në renovimin e kësaj shkolle në Ferizaj?

Zonja ministre, shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Gjon Serreçi” në Ferizaj është një ndër shkollat më të vjetra dhe më të mëdhatë në komunën e Ferizajt. Në këtë institucion të mësimit kanë kryer shkollimin e ulët qindra-mijëra nxënës. Si një ndër shkollat më të vjetra në Ferizaj, me mbi 2 500 nxënës, ajo nuk është në gjendje të mirë infrastrukturore dhe sanitare. Stafi i kësaj shkolle po përballet me vështirësi të shumta në funksionimin normal për shkak të vjetërsisë së saj e rrjedhimisht gjendja është e rëndë, duke filluar nga rreziku i rrjetit të stërvjetëruar elektrik, mungesa e vazhdueshme e ujit, dyert e dritaret të amortizuara deri te platformat e betonit të dëmtuara gjithandej objektit të shkollës.

Për rrjedhojë, duhet intervenim i shpejtë dhe konkret për të përmirësuar këtë gjendje të rëndë dhe të papranueshme. Prandaj, zonja ministre, a mund të më thoni, se kur do të ndodhë renovimi i kësaj shkolle?

KRYETARI: Urdhëroni, zonja ministre!

MINISTRJA ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit!

I nderuar deputet Reçica, faleminderit për pyetjen.

Për informatën tuaj, vitin e kaluar deputeti Dimal Basha dhe deputeti Enver Haliti kanë paraqitur një amendament, me të cilin kanë paraparë renovimin e shkollës “Gjon Serreçi” në Ferizaj.

Për këtë arsye, Qeveria kishte planifikuar mjetet dhe është votuar në Buxhet. Kanë qenë të ndara 150 mijë euro për renovimin e shkollës “Gjon Serreçi”, sepse është nevoja urgjente për renovimin e asaj ndërtese. Sido që të jetë, ka pasur kundërshtime nga kryetari i Komunës dhe drejtori i Arsimit, të cilët janë deklaruar se nuk duhet të ndodhin këto renovime aty dhe nuk kanë dërguar asnjë propozim për më tutje. Por, për informatën tuaj, objekti i kësaj shkolle është trajtuar me kujdes të veçantë nga Ministria e Kulturës dhe i njëjti është i përfshirë në listën e monumenteve të mbrojtura. Mjetet janë në buxhet dhe tashmë Ministria e Kulturës ka bërë edhe gjithë planifikimin dhe analizën për investimet që duhen aty, pra për ta trajtuar si objekt i mbrojtur dhe kjo gjë do të ndodhë gjatë vitit të ardhshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Reçica, dëshiron pyetje tjetër?

ELMI REÇICA: Nuk di a ta quaj pyetje, apo konstatom?

Për këtë çështje jam i njoftuar, zonja ministre. E di që është në listën e përkohshme të trashëgimisë kulturore, nën mbrojtje të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin 2023, kategoria e dytë, trashëgimi arkitekturore. Këtë e kam të qartë. Mirëpo, esenca është se në një anë e kemi një ministër dhe një ministri, që përkohësisht e ka vënë nën mbrojtje, në anën tjetër, s’kemi kurrfarë investime, ndërsa gjendja është e tmerrshme.

Nuk e di a keni qenë atje në atë shkollë, mirëpo gjendja është shumë e rëndë, e tmerrshme. Tash, as nuk po rinovohet siç është, as nuk po investoni, që së paku të kenë kushte normale.

Kolegë deputetë, unë e di që ata kanë postuar dhe kanë nxjerrë për vite të tëra filmime nga ajo shkollë, sa kanë qenë në opozitë. Tash, u bë viti i tretë që jeni në pozitë dhe s’po ndryshon fare. Atë që unë e kam...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Po, ia japim edhe një mundësi tjetër për përgjigje zonjës Nagavci, të shohim se si qëndron puna.

MINISTRJA ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit!

Pra, deputet Reçica, edhe një herë, që të jem e qartë.

Buxheti ka ekzistuar, zyrtarët e Ministrisë së Arsimit kanë pasur takim personalisht me kryetarin e Komunës dhe drejtorin e Arsimit, të cilët nuk kanë qenë të interesuar dhe nuk kanë lejuar që të ndodhë asnjë renovim ty.

Përtej kësaj, unë kam qenë personalisht, e di që është tepër e nevojshme të investohet aty dhe e kemi marrë me shumë prioritet, njëjtë sikurse edhe ministri i Kulturës, me të cilët jemi në bashkëpunim të ngushtë. Është bërë analiza, është bërë projekt-propozimi dhe shumë shpejt, gjatë vitit të ardhshëm, do të fillojë restaurimi që nënkupton edhe renovimin e objektit sipas kërkesave dhe kriterëve që janë paraparë për objektet e mbrojtura dhe i njëjti objekt do të vazhdojë të përdoret si shkollë, por me kushte më të mira, për nxënësit e gjimnazit. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro!

ELMI REÇICA: Më mbeti në gjysmë fjala që desha të them.

KRYETARI: Po, lirisht. E keni rastin ta mbyllni diskutimin.

ELMI REÇICA: Unë nuk kam qenë dakord që ajo shkollë të vihet nën mbrojtje si trashëgimi kulturore. E kam thënë këtu në këtë seancë, kur i kam parashtruar pyetje ministrit të Kulturës, për shumë arsye. Sepse leja është kërkuar në regjionin e Gjilanit, nuk është pyetur regjioni i Ferizajt dhe ajo është qartësuar.

Esenca është, se jeni me një Qeveri, shkolla e ka gjendjen e keqe, nuk i pyetni ju shumë kryetarët e komunave, as drejtorët e arsimit, kur ka të bëjë me çështje të tjera. E tash, po thirreni që ende s'keni marrë leje prej tyre!

Merreni, filloni e rinovoni, e keni marrë vendimin, kjo është çështje e juaj, por megjithatë krijoni kushte adekuate sa më normale, që ajo shkollë të funksionojë. Edhe një herë po e them, e kam parë një dokumentar, e kam parë një reportazh të një televizioni dhe gjendja është e tmerrshme. S'po them tash se...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Deputetja Arbëresha Kryeziu-Hyseni e ka tërhequr pyetjen e saj. Po ashtu, edhe Ganimete Musliun nuk e kemi këtu, kështu që vazhdojmë.

Hyjmë në rendin e ditës, sa i përket asaj që u pajtuam më herët për këto marrëveshjet ndërkombëtare.

Shikojmë se a kemi kuorum fillimisht. Presim jo fort gjatë, sepse kjo është përgjegjësi e deputetëve që të vijnë e të paraqiten. Presim nja pesë minuta dhe pastaj vazhdojmë. Shikojmë a i kemi 80 deputetë.

(Ndërprerje e incizimit)

74 deputetë janë në sallë për momentin. Presim veç edhe pak dhe shkojmë në pushim.

(Ndërprerje e incizimit)

Po bie numri i deputetëve, nga 74 në 70, kështu që shkojmë në pushim dhe kthehemi fiks në orën 15:30.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.

KRYETARI: Shumë pak deputetë kanë ardhur në këtë pjesë të seancës së pasdites, por tek e fundit, është përgjegjësi e grupeve parlamentare kjo që t'i mbajnë deputetët e tyre të përgjegjshëm për punën që na e kanë dhënë qytetarët e Kosovës.

Më tregoni, administrata, sa jemi, nuk më duket që janë 80, uluni nëpër vendet tuaja!

Kemi marrëveshjet ndërkombëtare në rend të ditës dhe kjo kërkon 80 vota për që të kalojnë.

66 deputetë, nuk ka kuorum për trajtimin e këtyre marrëveshjeve ndërkombëtare.

Nëse doni, mund ta trajtojmë ndonjë projektligj.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-052 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës

Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka rishqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, por ka vlerësuar se raporti i mëhershëm për këtë projektligj nuk ka nevojë të ndryshohet, se edhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij ashtu siç është në variantin e parë.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se projektligji, bashkë me amendamentet e propozuara, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Kurse Komisioni për Integritet Evropian ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk rregullohen në mënyrë specifike nga legjislacioni i BE-së.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve nuk e ka miratuar fare raportin dhe ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet e propozuara shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Ia japim fjalën kryetarit të Komisionit për Legjislacion, Adnan Rrustemi, për ta paraqitur raportin e komisionit.

ADNAN RRUSTEMI: Faleminderit, kryetar!

Para se të paraqes rekomandimin në emër të komisionit, më lejoni pak të bart te ju kontekstin për sa i përket këtij projektligji.

Ky projektligj është miratuar në lexim të parë dhe ka qenë në rend të dite për miratim në lexim të dytë në sesionin pranveror, por pasi që ishin paraqitur disa dilema në seancë plenare, kur pritej të votohej në lexim të dytë, ne e kemi tërhequr nga rendi i ditës, e kemi kthyer përsëri në Komisionin për Legjislacion, kemi themeluar grup të ri punues dhe i kemi sqaruar të gjitha dilemat.

Kemi risjellë raportin me amendamente, raporti me amendamente është i pandryshueshëm, sepse nuk ka pasur nevojë për ndërhyrje, thjesht pas një diskutimi me aktorët janë sqaruar të gjitha çështjet, kështu që kemi proceduar për miratim.

Natyrisht ky projektligj është pjesë e projektligjeve ose të ligjeve që parashihen të miratohen dhe është pjesë e Raportit të progresit. Ne sugjerojmë që sot të miratohet raporti me amendamente në lexim të dytë dhe projektligji në lexim të dytë. Kështu që komisioni i rekomandon seancës miratimin edhe të projektligjit, edhe të raportit me amendamente, pasi që janë hequr të gjitha dilemat për të gjitha grupet parlamentare.

KRYETARI: Për këtë projektligj a dëshironi të flisni, zoti Tahiri? E keni kërkuar fjalën, këtu më figuron që po.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Ne u ndalëm për t'i votuar marrëveshjet ndërkombëtare, po shihet që s'ka kuorum. Ju vazhduat tutje.

Unë e kam një propozim, se tash kur të hyjmë në votim, në momentin kur dalim në votim dhe ne nuk marrim pjesë në votim, shihet që s'ka kuorum. Unë po e shfrytëzoj rastin t'u uruar festat e fundvitit të gjithë qytetarëve të Kosovës, më së shumti policëve të Kosovës, me veçanti diasporës dhe lidërsipin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që i kemi në Hagë, urime u qoftë ky Viti i Ri, po shihet që s'ka numra, dhe kaq. Tash kur shkojmë në votim, e sheh që s'ka numra, do të mbyllet, prandaj e shfrytëzova rastin të bëj një urim. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Beqa, a në vazhdimësi të urimeve apo do të flasësh diçka për projektligjin.

HAJDAR BEQA: Po, kryetar, realisht deri sa s'ka kuorum për marrëveshjet ndërkombëtare, edhe urimet e kanë kuptimin.

I bashkëngjitem zotit Tahiri, i urojmë qytetarëve që viti i ardhshëm të jetë më i mirë për ta dhe më i begatshëm.

Megjithatë, sa i përket Ligjit për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës ka qenë një dilemë e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, i cili e ka ngritur në seancën kur

ishite ligji në lexim të dytë, realisht është një praktikë, ndoshta apo një veprim i mirë që u kthye në lexim të tretë.

Ne si Komision për Legjislacion, respektivisht si grup punues dilemat që i kemi pasur si Parti Demokratike kryesisht kanë qenë për ligjin bazë më shumë, po edhe një pjesë kanë qenë edhe për plotësim-ndryshimet. E kemi mbajtur grupin punues, i kemi dëgjuar të gjithë aktorët, e thënë të drejtën, edhe aty Agjencia Kadastrale e Republikës së Kosovës që ka mandat të përhershëm kushtetues dhe Agjencia për Verifikim dhe Krahasim të Pronës nuk kanë pasur një dakordancë, kanë pasur qëndrime të ndryshme pikërisht në dilema të cilat i ka ngritur Partia Demokratike, megjithatë, si anëtar i grupit punues dhe si përfaqësues i Partisë Demokratike që ishim aty, ne nuk kemi arritur të marrim një të vërtetë, se cila është më e saktë nga qëndrimet të dy agjencive. Nëse shikojmë në parim, Agjencia për Krahasim dhe Verifikim ka mandat që buron nga Marrëveshja e Brukselit dhe kryesisht mandati kryesor i saj është të bëjë krahasimin dhe verifikimin e pronave.

Megjithatë, ne nuk kemi arritur t'i sjellim dokumentet si shtet dhe nuk po arrijmë ende, edhe pse kjo marrëveshje është bërë një kohë e gjatë që është nënshkruar nga dy shtetet, nuk kemi arritur si Republikë t'i sjellim nga Serbia në Republikën e Kosovës. Ato një farë forme, në mënyrë të padrejtë janë marrë nga Kosova. Andaj, megjithatë, edhe pse s'ka pasur një sqarim në dilemat e ngritura nga Partia Demokratike, dy agjencitë i kanë pasur tregimet e tyre dhe ne në këtë fazë, edhe pse kemi tërhequr ligjin, nuk kam parë një dakordancë agjencitë në mes veti, në këtë rast konsideroj se në raport mes dy agjencive, duhet qenë një ekuivalencë apo të shkohet më shumë kah Agjencia Kadastrale e Republikës së Kosovës. Ajo ka pasur një qëndrim më shumë me idenë e Partisë Demokratike.

Megjithatë, ne do ta përkrahim sot në këtë formë si është ligji dhe do të shikojmë bashkë me aktorët, do të bisedojmë që në të ardhmen ndoshta dilemat t'i rishikojmë në tërësi të këtij ligji, me plotësim-ndryshim të ri apo ndoshta edhe një plotësim më të thellë apo më gjithëpërfshirës. Faleminderit!

KRYETARI: 14 amendamente janë, me sa po e shoh, të propozuara për këtë projektligjit, të gjitha qenkan prej Komisionit FunkSIONAL të propozuara.

Sa deputetë i kemi tash, na tregoni, ju lutem? 66.

66 deputetë, a i hedhim këto amendamente të gjitha në votim? Mirë.
Amendamentet për projektligjin në fjalë.

Kush për këto amendamente?

Kush është kundër këtyre amendamenteve?

Kush abstenon për këto amendamente?

62 deputetë votuan.

Të gjitha votat për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim. Kalojnë amendamentet në fjalë.

E hedhim projektligjin, bashkë me amendamentet. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës.

E votojmë ligjin së bashku me këto amendamente të cilat u votuan me 62 vota.

Kush është për këtë projektligj?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Nga 66, vetëm 60 deputetë po votojnë për këtë projektligj. Kështu që nuk kalon.

E hedhim edhe një herë në votim projektligjin që e kemi në diskutim është për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikimin e Pronës.

Kush e voton këtë projektligj?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Prapë 60 paskan votuar, paskan dalë deputetët apo nuk e keni numëruar ndoshta zotin Lushtaku, apo s'ke votuar ti? A herën e dytë s'paska votuar, ajo ishte dilema ime.

Tash jemi 65, po pesë nuk po votojnë. Kush po voton kësaj radhe?

Ta mbyllim këtë vit në mënyrë pozitive.

Sa u bënë tash? 66.

E hedhim projektligjin në votim.

Kush është për këtë projektligj?

Kush është kundër projektligji?

Kush abstenon?

62 deputetë votuan.

61 deputetë pro projektligjit, një deputet abstenoi.

Konstatohet që kalon projektligji.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/I-152 për antidopingun

Janë disa amendamente të propozuara individualisht prej deputetëve, të shkojmë sipas procedurës. Po deputetin Haxhiu nuk e kemi këtu. S'ke të drejtë të marrësh pjesë, se dole jashtë seancës më herët.

Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për antidopingun.

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Arsim e ka shqyrtuar Projektligjin për antidopingun dhe na ka rekomanduar miratimin e tij, së bashku me amendamentet që ai përmban.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se projektligji përmban implikime buxhetore shtesë të përballueshme për buxhetin e Republikës së Kosovës.

Ndërkaq amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për Legjislacion ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

Komisioni për Integritet Evropian ka vlerësuar se ky projektligj dhe amendamentet nuk rregullohen në mënyrë specifike prej legjislacionit të BE-së.

Komisioni për të Drejta dhe Interesa të Komuniteteve, në anën tjetër, ka vlerësuar se edhe projektligji edhe amendamentet nuk e cenojnë dhe nuk i prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

E ftoj kryetarin e Komisionit për Arsim. Ia japim fjalën deputetit Ardian Gola ta arsyetojë raportin.

ARDIAN GOLA: Faleminderit, kryekuvendar!

Përrjashtimisht rezymesë që i bëre këtij projektligji, përkatësisht procedurave nëpër të cilat ka kaluar, unë vetëm do të thosha që ky projektligj mbulon një çështje jashtëzakonisht sensitive dhe tepër të rëndësishme. Ka kaluar nëpër të gjitha fazat procedurale, më konkretisht më 22 shtator të këtij viti, para miratimit në parim të këtij projektligji në Kuvend, e ka shqyrtuar dhe i ka rekomanduar Kuvendit për të vazhduar tutje me procedurat shtesë.

Sa për informatë, Komisioni për Arsim dhe Sport ka qenë në një kontakt të vazhdueshëm me Agjencinë Ndërkombëtare të Antidopingut, VAD-ën, me fjalë të tjera ka vazhduar komunikimin intensiv me këtë agjenci, ashtu sikurse ka proceduar edhe Qeveria, dhe arsyeja për këtë

komunikim intensiv ka qenë që të kemi një projektligj, i cili është saktësisht në të njëjtën linjë me përmbajtjen e kodit të VAD-ës, i cili është kod ndërkombëtarisht obligativ për të gjitha shtetet, për sa i përket çështjes së rregullimit juridik të fushës së sportit.

Më duhet të bëj një sqarim prej tash dhe të kërkoj me mirëkuptim nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në amendamentin 9, i cili është i propozuar unanimisht nga komisioni, është përkufizimi i dopingut, i cili në dispozitën autentike të kodit të VAD-ës përmban termin *occurrence*, por që në gjuhën shqipe kur është përkthyer e kemi hequr si komision unanimisht, për shkak se nuk përkon me frymën e gjuhës shqipe. Mirëpo, dua t'ju informoj dhe të jeni të bindur që dispozita aktuale në formën e amendamentit se si ka ardhur nga komisioni, e reflekton në mënyrë absolute përmbajtjen juridike të kësaj dispozite në kodin e VAD-ës dhe ajo çfarë ka ndodhur më pas në zyrën e përkthimit, kur është përkthyer amendamenti i propozuar nga komisioni, nuk është përfshirë termi *occurrence*, përkundër kërkesës që është bërë që të merret në tërësi dhe shprehimisht ad verbatim dispozita nga kodi i VAD-ës dhe më pastaj në gjuhën angleze është hequr termi *occurrence* dhe Agjencia antidoping është duke kërkuar me ngulm që të mos ndryshohen dispozitat e kodit të VAD-ës në gjuhën angleze, pra të ruhet terminologjia.

Pra, ajo çfarë unë po kërkoj, në mënyrë që të lehtësojmë aspektet procedurale dhe për shkak të ndjeshmërisë dhe rëndësisë që ka ky projektligj, të kalojë gjatë këtij sezoni, është që pas procedurës së spastrimit që pason pas miratimit në Kuvend, në gjuhën angleze vetëm të shtohet termi *occurrence*, që është formulim autentik i dispozitës në kodin e VAD-ës, ndërkohë që në gjuhën shqipe mbetet ashtu sikurse është, pa u afektuar aspak në përmbajtjen e saj.

Përndryshe, në të gjitha aspektet e tjera të procedurës në këtë ligj janë zhvilluar sipas rregullores dhe ligjeve në fuqi dhe me këtë do të shprehja edhe një kërkesë, që të votojmë këtë projektligj dhe prej vitit të ardhshëm, meqë kemi të bëjmë me një fushë ku Kosova po dëshmon gjithnjë më shumë potencial, sidomos në futboll, në sporte të tjera të mundjes, të kemi edhe një ligj që rregullon këto çështje të dopingut. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Gola, a bën pak disa konsultime, se nuk shkon kështu.

(Ndërprerje e incizimit)

Jo, nuk kemi mundësi.

Mirë, e hedhim raportin si në versionin e tij origjinal, siç ka qenë, jo me ndryshimet që na kanë ardhur tash së voni prej komisionit. Kjo nuk është e mundshme kështu të procedohet. Ne e hedhim ashtu. E di që qysh po shpjegon zoti Gola është shumë më e logjikshme, në versionin e tij shqip.

Po, jo, se s'po e prek substancën ky interpretim. Aty është fjalia "... ndodhja e shkeljeve." "Ndodhja e shkeljeve...", që në gjuhën shqipe është më mirë ta eliminojmë atë terminologji e të thuhet drejtpërdrejt "shkeljet", "sa herë që ndodhin shkeljet...", jo "sa herë që kemi ndodhje të shkeljeve". Po pajtohem unë gjuhësisht që... mirëpo le të jetë kjo atëherë me këshillën që versioni anglisht është shumë më i saktë edhe gjuhësisht sesa versioni shqip që e kemi. Mirë.

Dëgjoni tash, se para se të kalojmë atje, i kemi edhe disa amendamente. Janë 15. I votojmë me rend, sepse amendamenti i parë i ka dy propozime.

(Ndërprerje e incizimit)

Ia japim fjalën zotit Haxhiu për të paraqitur versionin B të amendamentit të parë, të cilin e ka propozuar ai.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në këtë projektligj për antidopingun kam parashtruar dhjetë amendamente, përmes të cilave jam munduar që përvojën time, ekspertizën time t'ia jap në dispozicion Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, që ta kemi një projektligj më të mirë, më të zbatueshëm. Përjashtimisht amendamenteve 4 dhe 5, ku kërkoj votën e deputetëve, amendamentet e tjera pothuajse janë të përfshira, por janë tani të propozuara si të komisionit, janë të plotësuara edhe me çështje të tjera.

Pra, e kërkoj votën e deputetëve vetëm për amendamentet 4 dhe 5, sepse amendamentet e tjera tanimë janë të përfshira.

Pse e kërkojmë votën e veçantë për këto dy amendamente, ka të bëjë me organizimin, ku unë edhe ekspertët e kësaj fushe mendojmë se duhet të jetë Agjencia Antidoping si pjesë e Qendrës Kombëtare të Mjekësisë Sportive, apo ashtu si e ka propozuar Qeveria, në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Disa prej vendeve në të kaluarën e kanë pasur agjencinë. Po e marrim shembull Kroacinë, si agjenci të veçantë në kuadër të qeverisë, më pastaj e kanë ndryshuar dhe e kanë futur në kuadër të Institutit të Shëndetit Publik. Në 99% të vendeve të botës ekziston te sektori i shëndetësisë, mirëpo në asnjë vend të botës nuk e gjeni një laborator të antidopingut në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Është e logjikshme që laboratorit të jetë pjesë e sektorit të shëndetësisë, sepse po flasim për analiza të gjakut dhe të urinës, pra analiza që duhet të bëhen për antidoping.

Përmbajtja e projektligjit ndryshon te këto dy amendamente, amendamenti 4 dhe 5. Pas disa vjetësh të mos ketë nevojë që ky projektligj të plotësohet dhe prapë të kthehet te pjesa e sektorit

të shëndetësisë, qysh e ka bërë Kroacia. Ta rregullojmë këtë çështje tani, këto të tjerat janë në rregull dhe janë në harmoni me rekomandimet e VAD-as.

E përgëzoj kryetaren e komisionit që ka qenë në vazhdimësi në konsultime me VAD-an, që të jetë një ligj realisht i mirë. Problemi është që kryetarja s'ka mundur të shkëputet prej pikëqëndrimit politik që ka sjellë Qeveria për t'i punësuar nja dymbëdhjetë vetë në agjenci. Edhe ajo është e drejtë, sepse e keni shumicën, mirëpo përtej punësimit të dymbëdhjetë vetëve, duam ta shohim funksionimin e Agjencisë Antidoping dhe ligjit antidoping në të ardhmen. Nëse ky ligj votohet sot dhe nuk pason me investime të tjera në infrastrukturën sportive, aktualisht ky ligj mund të zbatohet e të aplikohet vetëm te stadiumi i Prishtinës. Stadiumi 'Fadil Vokrri' është i vetmi stadium në Republikën e Kosovës që ka dhomën mjekësore dhe ka hapësirën për të marrë mostrat antidoping. Asnjë objekt tjetër në kuadër të Republikës së Kosovës nuk i plotëson kriteret që një mostër të merret për testim dhe të jetë valide dhe e vlefshme për procedura të mëtejme.

Prandaj, nëse ligji nuk pasohet me projektet e investimeve, bëhet ligji, punësohen nja dymbëdhjetë vetë dhe rregullohet kjo punë sa i përket punësimit, por zbatimi do të jetë pastaj problematik. Prandaj, i nderuar kryetar, kërkoj prej jush që të hidhen në votim dy amendamentet, 4-shi dhe 5-shi, si të përbashkëta, sepse janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën, ndërsa amendamentet e tjera tanimë komisioni i ka akceptuar si pjesë të projektligjit dhe nuk ka nevojë që të hidhen në votim. Faleminderit!

KRYETARI: Kërkesa juaj është e pamundur, zoti Haxhiu, sepse këtë mund ta bëjmë vetëm për 5-shin, jo për 4-shin. 4-shin duhet ta hedhim në votim së pari amendamentin e komisionit, sepse amendamenti i komisionit hidhet i pari në votim. Ky ka plot amendamente, zoti Haxhiu, por këtë 4-shin e 5-shin... jo, jo. Po e kuptoj, ama në votim hidhet vetëm 4-shi. Për 4-shin hidhet vetëm i komisionit, jo amendamenti juaj. Sepse, nëse fiton i komisionit, amendamenti juaj mbetet pa efekt pastaj. Vetëm për këtë e kam. E te 5-shi, komisioni nuk ka hiç, është vetëm propozimi juaj. Atëherë, e hedhim vetëm tuajin.

Urdhëro!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Rregullorja thotë se cili prej amendamenteve merr më shumë vota, ai kalon, kur janë dy amendamente.

KRYETARI: Po, veç nëse kalon i komisionit, nuk hidhet i juaji fare në votim.

BEKIM HAXHIU: Cila të marrë vota më shumë.

KRYETARI: Dëgjo, nëse ai i pari...

BEKIM HAXHIU: Lexoje Rregulloren drejt! Nëse amendamenti 4 nuk kalon, atëherë edhe pesëshi, pra janë të ndërlidhura njëri me tjetrin. Funksionimi i agjencisë pastaj nuk mund të...

KRYETARI: A mund të ta lexoj qysh thotë saktë?

Nëse për një nen ka më shumë se një amendament, së pari votohet amendamenti i propozuar nga komisioni përgjegjës raportues. Nëse amendamenti i komisionit kalon, amendamenti tjetër nuk votohet fare, nuk hidhet fare në votim, a po kupton? Kështu ka qenë gjithmonë dhe kështu do të jetë. Tash, çështja është se për amendamentin 4, për amendamentin tënd që e ke paraqitur, nëse kalon i komisionit, nuk e trajtojmë fare amendamentin tuaj. Vetëm këtë e kam për ta sqaruar. Mirë.

Vazhdojmë pra. Komisioni Funkcional, meqenëse zoti Haxhiu u tërhoq nga amendamentet e tij, po i qesim në votim fillimisht amendamentin 1, 2 dhe 3.

Kush është për këto amendamente? Kush është kundër? Kush abstenon?

62 vota. Miratohen amendamentet 1, 2 dhe 3.

Për amendamentin 4 janë dy propozime, siç e dëgjuat edhe zotin Haxhiu, është edhe amendamenti i tij, në të cilin ai po insiston që të hidhet në votim, por së pari e hedhim në votim amendamentin e Komisionit Funkcional.

Kush është për amendamentin 4? Kush është kundër? Kush abstenon?

Konsideroj që këtu kemi ngecur. Nuk ka... po, mirë. Edhe dy vota të tjera abstenime. Prapë s'mjaftojnë. Mendoj që diku të 59-shi mund të jetë, ose 58-shi, a? Vetëm 58. Nuk ka kuorum për amendamentin nr.4, kështu që konsideroj që nuk mund të vazhdojmë kështu. Presim edhe dy minuta, nëse nuk ka deputetë, atëherë e ndërpresim seancën.

(Ndërprerje e incizimit)

Vetëm 60 deputetë po marrin pjesë në seancë dhe 4 deputetë nuk po votojnë, kështu që ne e ndërpresim këtu. Faleminderit shumë!

Gëzuar Krishtlindjet! Urime Vitin e Ri! Shihemi në sesionin e ardhshëm. Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*